

# EPOKA

## ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7010  
E hënë, 2 tetor 2023  
Çmimi 0.50

Mirëpritet propozimi  
i presidentes që për  
Asociacionin të diskutohet  
me ShBA-në Faqe 3



26 VJET NGA PROTESTA E LËVIZJES STUDENTORE E VITIT 1997 Faqe 4

### PROTESTA E LËVIZJES STUDENTORE E '97-s I DHA SHPIRT PLATFORMËS PËR ÇLIRIM DHE SHTET TË PAVARUR



26-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë kujtuar liderët e Lëvizjes Studentore dhe profesorë universitarë që ishin pjesë e asaj proteste. Në këtë

pervjetor u theksua se kjo lëvizje u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytetarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotore të luftës për liri dhe pavarësi. Kjo ngjarje, thuhet nga

profesorët universitarë, duhet të shënohet në tekstet shkollorë dhe të kujtohet nga gjeneratat e reja si akt sublim i fillimit të procesit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës

**HOXHAJ:  
SUKSESI I POLICISË  
TË PËRKTHEHET  
NË FITORE  
DIPLOMATIKE,  
TË SANKSIONOHET  
SERBIA**



**MICHAELIS:  
GJERMANIA DHE  
SHBA-ja JANË  
NË KOORDINIM  
TË NGUSHTË PËR  
SITUATËN NË  
VERI TË KOSOVËS**



**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni  
Xheqisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501289  
E-mail: renova@mt.net.mk

**PRINCESHA**  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA  
DEGA KOSOVO  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://www.facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



### OPINION

**SKENARI I PËRFITIMIT TË  
ALBIN KURTIT MBI GJAKUN  
DHE FATKEQËSITË E TË  
TJERËVE** F.7

Shkruan:  
Prof. dr. Kudusi  
LAMA, gjeneral në  
pension



### AKTUALE



**OSMANI: SERBIA DUHET TA DIJË SE  
DO TË PËRBALLET ME NJË POPULL  
TË GATSHËM PËR TA MBROJTUR  
LIRINË ME ÇDO KUSHT** F.7

**SVEÇLA DHE HOXHA: AUTORËT E  
SULMIT TË 24 SHTATORIT NË VERI  
U PËRGATITËN NË PRONËN E  
RADOIQIQT** F.7

**MBYLLJA E QEVERTË AMERIKANE  
SHMANGET NË ÇASTIN E FUNDIT** F.2

### EKONOMI



**PDK-ja NUK PAJTOHET ME  
PUSHTETIN PËR NUMRIN E TË  
PUNËSVARAVE NË KOSOVË** F.8

**ASK-ja: MË SHUMË TË PUNËSVAR  
ME PAGË PRIMARE DHE SEKONDARE  
NË GUSHT TË 2023-S SESA NJË VIT  
MË PARË** F.8

## Michaelis: Gjermania dhe ShBA-ja janë në koordinim të ngushtë për situatën në veri të Kosovës

**UASHINGTON, 1 TETOR** - Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) janë duke u koordinuar ngushtë pas zhvillimeve të fundit në Kosovë ka thënë

ambasadori gjerman në ShBA, Andreas Michaelis. Michaelis ka shkruar në "X" se Kosova dhe Serbia janë fuçi baruti në Evropë. Duhet të merret seriozisht rreziku. Koordinim shumë i ngushtë mes Gjermanisë

seriozisht rreziku. "Kosova/Serbia është një tjetër fuçi baruti në Evropë. Duhet të merret seriozisht rreziku. Koordinim shumë i ngushtë mes Gjermanisë

dhe ShBA-së në ditët dhe orët e fundit. Absolutisht çelësi për ta shmangur përshkallëzimin e mëtejshëm. Serbia duhet të veprojë tani", ka shkruar Michaelis.



## Mbyllja e qeverisë amerikane shmanget në çastin e fundit

**UASHINGTON, 1 TETOR** - Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka shmangur mbylljen federale, pasi Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati janë pajtuar për një marrëveshje financimi afatshkurtër të shtunën.

Një projektligji i cili e mban të finansuar qeverinë deri më 17 nëntor, por në të cilin nuk përfshihet mbështetja e re për Ukrainën, është miratuar në Senat me 88 vota për dhe nëntë kundër.

Presidenti Joe Biden e ka nënshkruar atë në ligj pak para se të skadonte afati në mesnatë. "Ky është lajm i mirë për popullin amerikan", ka thënë Bideni në një komunikatë për medie.

Ky propozim është bërë nga kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, i cili është përballur me kundërshtime të mëdha nga ligjvënesit e ekstremit të djathë nga partia e tij. Mbyllja e qeverisë, e cila do t'i konte dhjetëra mijëra punonjës federalë në pushim pa pagesë dhe do t'i pezullonte shërbimet e ndryshme qeveritare, pritej të ndodhë më 1 tetor.

Por, kthesa dramatike ka ndodhur të shtunën mbrëma, pasi republikanët e Dhomës së Përfaqësuesve ia kanë dalë ta miratojnë masën e financimit të përkohshëm, i cili do ta mbajë qeverinë të hapur deri kah mesi i nëntorit dhe nuk do të bëjë më



koncesione të mëdha për nivelet e shpenzimeve. Kjo masë ka marrë mbështetje më të madhe nga demokratët se nga republikanët, sepse hiç më pak se 90 republikanë votuan

kundër saj.

Për një grup të vogël të republikanëve të ekstremit të djathë kjo ishte një goditje e rëndë, të cilët kishin mbajtur bisedime në Dhomën e

Përfaqësuesve me kërkesa këmbëngulëse për uljen e shpenzimeve.

Megjithatë, duke qenë se shumica e ligjvënesve ishin të vendosur për ta shmangur mbylljen, njëra nga kërkesat kryesore e këtij grup – ndalja e financimit të luftës së Ukrainës kundër pushtuesit rus – reflektohet në këtë projektligji. Bideni ka theksuar se Shtetet e Bashkuara "nuk mund të lejojnë, në asnjë rrëthanë, që përkrahja amerikane për Ukrainën të ndërpitet", duke shtuar se pret nga McCarthy "të vazhdojë të jetë i përkushtuar ndaj popullit ukrainas dhe ta sigurojë miratimin e mbështetjes së nevojshme për ta ndihmuar Ukrainën në këtë çast kritik".

## Sulm me bombë pranë ndërtesave ministrore në Ankara



afér Parlamentit dhe ndërtesave ministrore.

Ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya, ka bërë me dije se

dy oficerë të policisë turke janë plagosur lehtë gjatë incidentit që ka ndodhur në orën 9:30 të dielën.

Nuk dihet deri tani se kush mund të jenë sulmuesit. Grupet militante kurde dhe të ekstremit të majtë si dhe Shteti Islamik kanë kryer sulme vdekjeprurëse nëpër Turqi në të kaluarën.

Yerlikaya ka thënë se sulmuesit mbërritën në kompleksin

ministror me një veturë të vogël komerciale. Në pamjet e publikuara nga vendi i ngjarjes shihen ekipet e shpëtimit duke punuar pranë një vture të parkuar në zonën pranë Parlamentit të Turqisë dhe ndërtesave ministrore. Policia e ka mbyllur qasjen në qendër të qytetit.

Dy oficerët e plagosur po trajtohen në spital dhe gjendja e

tyre nuk është e rëndë, sipas medieve lokale. Ndërsa presidenti turk, Rexhep Taip Erdogan, ka thënë se "terroristët" nuk do t'i arrijnë kurrë qëllimet e tyre në Turqi. Ky sulm është dënuar nga shumë shtete, duke përfshirë Kosovën dhe Shqipërinë. Po ashtu, sulmin në Ankara e ka dënuar edhe Bashkimi Evropian (BE).

## Partia majtiste e ish-kryeministrit pro-rus i fiton zgjedhjet në Slloveni

**BRATISLAVË, 1 TETOR** - Partia majtiste e ish-kryeministrit Roberto Fico i ka fituar zgjedhjet parlamentare të së shtunës në Slloveni, pas një fushatë pro-ruse dhe mesazheve anti-amerikane, kur janë numëruar pothuajse të gjitha votat. Partia e Ficos, Drejtimi Social Demokrat, SMER-SSD, ka dalë e para me 22.9 përqind, ka bërë me dije të dielën Zyra e Statistikave të Sllovensë, pasi janë numëruar 99.98 përqind të votave nga 6 000 vendvotime. Zgjedhjet e së shtunës ishin një test përvendim i vogël të Evropës lindore në lidhje me mbështetjen e fqinjës të saj, Ukrainës, në luftën kundër Ruseve, prandaj fitorja e Ficos mund ta dëmtojë edhe më shumë unitetin e brishtë në

Bashkimin Evropian dhe NATO. Fico është zotuar se do ta ndalë mbështetjen ushtarake të Sllovensë për Ukrainën në luftën e saj kundër pushtuesit, Ruseve, nëse ia del të kthehet në pushtet. Sllovenia ka qenë përkrahëse e madhe e Ukrainës qëkur Rusia e ka nisur pushtimin e saj në shkurt 2022, duke i dhuruar armatim dhe duke i hapur kufijtë për refugjatët e ikur nga lufta.

Meqë asnjë parti nuk e ka fituar shumicën parlamentare, atëherë nevojitet koalicion përfundimin e qeverisë së re. Presidenti tradicionalist i kërkon fituesit të zgjedhjeve të përpinqet ta formojë qeverinë e re, prandaj gjasat janë shumë të mëdha që Fico të bëhet përsëri kryeministër.

Ai ka shërbuer kryeministër nga

viti 2006 deri në vitin 2010 dhe përsëri nga viti 2012 deri më 2018. Partia liberale pro-romane, Partia Sllovenia Progrezive (PS), ka dalë e dyta me 18 përqind të votave të fituara.

Lideri i saj Michal Simecka, i cili është nënkyetar i Parlamentit Evropian, ka thënë se partia e tij e pranon rezultatin e zgjedhjeve. "Por, ky është lajm i keq për Slloveninë. Do të jetë edhe më keq nëse Roberto Fico ia del ta formojë qeverinë", ka thënë Simecka.

Partia tjetër majtiste, Zéri, e udhëhequr nga ish-zëvendësi i Ficos, Peter Pellegrini, ka dalë e treta me 14.7 përqind të votave. Pellegrini e ka uruar Ficon përfitoren, por ka thënë se dy ish-kryeministra në një qeveri mund

të mos shkojë mirë. "Nuk do të ishte ideal, por kjo nuk nënkupton se një koalicion i tillë nuk mund të krijohet", ka thënë Pellegrini.

Një partner tjetër i mundshëm për koalicion përfundit, Vladimir Putin, se Qeveria e Ukrainës e udhëheq një shtet nazist nga i cili duhet të mbrohen rusët etnikë në lindje të vendit. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, është hebre dhe ka humbur të afërm të vet në holokaust.



# Mirëpritet propozimi i presidentes që për Asociacionin të diskutohet me ShBA-në

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Propozimi i presidentes Vjosa Osmani, që draft-statutit i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë të përgatitet bashkë me ShBA-në, është mirëpritur nga njohësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Sipas tyre, me amerikanët duhet të vendoset që Asociacioni mos të ketë kompetenca ekzekutive që e paralizon funksionimin e Kosovës. Ata kanë thënë se pavarësisht prej zhvillimeve të fundit dhe sulmit terrorist në veri, dialogu nuk ka alternativë.

Megjithatë, në partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje, mbesin të vendosur se kushtëzimi për Asociacionin në kuadër të marrëveshjes së Brukselit dhe të Ohrit nuk do të zbatohet.

Profesori universitar Arben Fetoshi ka thënë për "Kosovapress" se kryeministri Albin Kurti duhet të ketë komunikim intensiv me përfaqësuesit e lartë të ShBA-së për Asociacionin, mbi bazën edhe të deklaratave të tyre se i njëjtë sđo të jetë një nivel tjetër i pushtetit në Kosovë.

"Ajo çka na duhet tani është një

komunikim intensiv i kryeministrat Kurti me aleatët, me zotëri Escobarin në radhë, të parë për t'i siguruar garancitë që Asociacioni të mos jetë mekanizëm që e paralizon funksionimin e Kosovës. Ju e dini se kemi marrë vazhdimit garanci nga ana ShBA-ja që Asociacioni të mos ketë kompetenca ekzekutive dhe Asociacioni sđo të jetë nivel tjetër i pushtetit në Republikën e Kosovës dhe mbi këtë bazë qeveria jonë duhet të lëvizë në drejtim të draftimit të statutit të Asociacionit në përputhje me vizionin e prezantuar nga kryeministri në mënyrë që pastaj presioni të zhvendoset mbi Vuçiqin", ka thënë ai.

Konstruktivitet në këtë temë pret edhe analisti politik Artan Muhamxhiri, i cili ka thënë se Kosova duhet ta ofrojë pozicionin e saj në raport me atë si e sheh Asociacionin brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kosovës. "Në momentin që pala kosovare do të dëshmohet si bashkëpunuese edhe këto presione do të largohen. Gjithsesi nuk duhet të harrohet në asnjë



moment që Asociacioni është pjesë esenciale e marrëveshjes finale. Pa garantimin e situatës së pakicës serbe në Kosovë, pas arritjes së marrëveshjes finale, pas një lloj njohje të shtetit të Kosovës nga ana e Serbisë, nuk mund të ketë asnjë mendim ose ide përfundim të suksesshëm të dialogut", ka thënë Muhamxhiri. Pavarësisht prej deklaratës së presidentes Osmani për

Kosovës, si deputetë, si politikanë kemi mjaft mësimë nga e kaluara dhe e dimë se qfarëdo hapa që marrin përfaqësuesit e Serbisë nuk mund të jenë hapa të drejtë dhe mund ta shohim situatën njëanshëm. Qëllimi i tyre është ta shtyjnë Asociacion e hapat e tjerë të marrëveshjes të mos realizohen kurrë", ka thënë Pacolli.

Pas sulmit terrorist në Banjskë të Zveçanit, presidentja Vjosa Osmani ka thënë se zgjdhja për Asociacionin është që Kosova të ulet me ShBA-në dhe ta përgatisë draft-statutin për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, brenda kornizës ligjore dhe kushtetuese të Kosovës.

Më 24 shtator një grup i armatosur rëndë terrorist ka sulmuar Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, ku mbeti i vrarë rreshteri policor Afrim Bunjaku. Asociacioni ishte pika ndarëse mes Kosovës dhe Serbisë edhe në takimin e nivelit të lartë të dialogut më 14 shtator në Bruksel, ku kryeministri Albin Kurti akuzoi Vuçiqin se po kushtëzon Asociacionin me zbatimin e marrëveshjes së Brukselit dhe të Ohrit.

# Hoxhaj: Suksesi i policisë të përkthehet në fitore diplomatike, të sanksionohet Serbia

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Nënkyetari i Kuvendit të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka dënuar ashpër sulmin terrorist të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit, ku ka mabetur i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku dhe janë plagosur dy policë të tjerë.

Ai ka thënë se është momenti i fundit që bashkësia ndërkombëtare ta sanksionojë Serbinë, derisa nga Qeveria e Kosovës ka kërkuar që suksesin e policisë ta përkthejej në fitore politike e diplomatike. "Së pari, mendoj që Serbia e ka marrë përgjigjen e plotë duke demonstruar nga ana e Republikës së Kosovës që kushdo që bënë përpjekje ta sulmojë sovranitetin dhe integritetin territorial do të pësojë sikur që e ka pësuar ai grup terrorist, të cilët bënë një akt të agresionit mbi Republikën e Kosovës. Së dyti, mendoj që akti si i tillë padyshim që ka lidhje me politikën serbe, me shtetin serb, me vetë Aleksandër Vuçiqin, meqë Aleksandër Vuçiqi para se të bëhet politikan ka qenë paramilitar dhe krejt çka e njeh ai në karrierën e tij të hershme është pikërisht organizimi paraushtarak, paramilitar sikurse ishte kjo bandë kriminale që sulmoi veriun e Kosovës dhe ne mendojmë që duhet të kemi një hetim ndërkombëtar mbi këtë çështje të pavarur dhe i takon Bashkimit Evropian si ndërmjetësues që pikërisht ta shtyjë çështjen e një hetimi ndërkombëtar meqë nuk mund të jeni në tavolinë të negocimit për normalizim të rapportit dhe në të njëjtën kohë të sulmoni një shtet sovran dhe të

pavarur... natyrisht që Serbia duhet të sanksionohet dhe është koha e fundit kur Serbia duhet të sanksionohet", ka thënë Hoxhaj për "KP".

Më tuje, nënkyetari i Kuvendit të Kosovës ka përmendur një mori argumentesh që e bëjnë Serbinë përgjegjëse për sulmin terrorist të së dielës së shkuar. "Padyshim se ajo çfarë ka ndodhur në veri të dielën ka qenë një sulm dhe akt agresioni i planifikuar, me agjendë të qartë politike, njerëz të cilët kanë qenë të trajnuar, armatim i cili është siguruar nga shteti serb dhe koha e prodhimit të këtij armatimi tregon që shteti serb është mbrapa dhe në Serbi nuk mund të blesh një pistoletë, revole në treg të zi, lëre më armatim për një këmbësori të rëndë me uniforma. Por, përtëj sasisë së armatimit, kohës së prodhimit, unë mendoj që vëmendja në Kosovë duhet të jetë rrëth agjendës së tyre politike, platformës, qëllimit të tyre politik dhe ajo se çfarë ka ndodhur të dielën nuk është asgjë tjetër veçse e ngashme me një përpjekje për ta aneksuar këtë pjesë të territorit të Kosovës. Në pikëpamjen time është e ngashme me aneksimin e Kumesë nga ana e Rusisë, është e ngashme me penetrimin e forcave paraushtarake, paramilitare, bandave kriminale në Donbas, është e ngashme me mënyrën sesi ka filluar lufta në Kroaci dhe se si ka qenë agjenda e politikës serbe për ta kontrolluar territorin e Kroacisë, është e ngashme me atë se çfarë ka ndodhur në Bosnjë. Partnerët tanë



ndërkombëtarë duhet ta shohin aktin e agresionit të së dielës si një pikë kthuese në raportet Kosovë - Serbi dhe në politikën rajonale", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se është e rendësishme që të hetohet në tërësi rasti dhe Kosova të ripozicionohet. Sulmi terrorist, kërcënimet e vazhdueshme të Serbisë dhe ambicjet e saj serbomëdha, Hoxhaj ka thënë se dëshmojnë se Kosova nuk guxon të kthehet në tavolinën e dialogut sikurse nuk ka ndodhur asgjë. "Duhet të ketë qartësi politike që dialogu të përfundojë me njohje të ndërsjellët, me marrëveshje obligative ligjore, e cila është finale mes Kosovës dhe Serbisë. Është agjenda politike ajo e cila ka qenë në vitet '90, e rikthyer përsëri në shtatorin e 2023-s dhe në këtë drejtim mendoj që Kosova nuk

policisë, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. "Nuk e shohim raportin tonë me shtetin e Kosovës prej asaj se a është dikush në pozitë apo në opozitë dhe natyrisht që i jepim mbështetje të plotë Policisë së Kosovës, Forcave të Sigurisë së Kosovës, AKI-së, të cilët kanë bërë një punë brilante në një situatë ku edhe shtetet e mëdha do ta kishin vështirë që të përballen nga një sulm në befasi dhe i papritur. Në këtë drejtim mendoj se jemi unikë pranë institucioneve të Kosovës. Ajo çfarë është shkruar në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës është në zemër të çdo deputeti dhe mendoj të çdo anëtar, të çdo qytetari, pavarësisht prej dallimeve partiakë që i kemi për tema të tjera", ka thënë Hoxhaj. Në orët e para të mëngjesit të 24 shtatorit është vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, ndërsa polici tjetër Alban Rashiti dhe një tjetër kanë mabetur të plagosur. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku është sulmuar patrulla poliore. Policia ka vrarë tre prej terroristëve dhe ka arrestuar tetë. Policia e Kosovës ka gjetur arsenal armësh në Manastirin e Banjskës, ku terroristët ishin strehuar. Autoritetet në Kosovë kanë nxjerrë prova që implikojnë nënkyetarin e Listës Serbe, Milan Radoçiq, si udhëheqës i këtij grupi terrorist. E ky i fundit, i cili është i sanksionuar edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, e ka pranuar se e ka udhëhequr grupin terrorist.

Kuvendi i Kosovës të enjten ka miratuar rezolutën që dënon sulmin terrorist ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator në Banjskë të Zveçanit. E për nënkyetarin e Kuvendit kjo është dëshmi e unititetit të pozitës dhe opozitës ndaj

26 VJET NGA PROTESTA E LËVIZJES STUDENTORE EVITIT 1997

# Protesta e Lëvizjes Studentore e '97-s i dha shpirt platformës për çlirim dhe shtet të pavarur

26-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë kujtuar liderët e Lëvizjes Studentore dhe profesorë universitarë që ishin pjesë e asaj proteste. Në këtë përvjetor u theksua se kjo lëvizje u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytetarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotore të luftës për liri dhe pavarësi. Kjo ngjarje, thuhet nga profesorët universitarë, duhet të shënohet në tekstet shkollorë dhe të kujtohet nga gjeneratat e reja si akt sublim i fillimit të procesit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës

**EPOKA  
ERE** **Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Të dielën janë mbushur 26 vjet nga protesta e Lëvizjes Studentore e vitit 1997. Ishte Lëvizja Studentore e atëhershme që organizoi protestat të cilat u organizuan për ta kundërshtuar pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe kthimin e studentëve në objektet universitare, nga të cilat studentët ishin dëbuar nga regjimi i kasapit, Sllobodan Milosheviqit, në fillim të viteve '90.

Përpos masave të dhunshëm që regjimi kishte vendosur vite më parë në universitet, dëboi studentë dhe profesorë nga universiteti dhe imponoi planprogramin serb përmësim. Kjo protestë konsiderohet një ndër aktet më të rëndësishme të asaj kohe. Për ta shpërndarë

protestën paqësore, policia serbe kishte përdorur dhunë ndaj studentëve dhe profesorëve. Në ballë të asaj proteste ishin liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, së bashku me rektorin e atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci. Pas tyre, në këtë protestë ishin edhe mijëra studentë dhe profesorë. 26-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë kujtuar liderët e kësaj lëvizje dhe profesorë universitarë që ishin pjesë e kësaj proteste.

Sot në këtë përvjetor theksohet se kjo lëvizje u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytetarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotore të luftës për liri dhe pavarësi.

Kjo ngjarje, thuhet nga profesorët universitarë, duhet të shënohet



## Kurti bëri homazhe te varri i profesor Ejup Statovcit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në 26-vjetorin e protestave studentore dhe në nderim të jetës dhe veprës së profesor Ejup Statovci, ka vendosur kurora me lule të freskëta dhe ka bërë homazhe te varri i tij, bashkë me Bujar Dugollin, Driton Lajçin, Hajrullah Koliqin, Ahmet Gecën, Lulëzon Jagxhiun, Jeton Rexhën dhe Atdhe Hykollin.

Duke e vlerësuar lart kontributin e profesor Statovcit, pas homazhevë kryeministri Kurti tha se ky nderim te varri i tij tregon se nuk e harrojmë atë datë dhe shtoi se i kemi aq shumë

borxh profesor Statovcit i cili Universitetin e Prishtinës e lartësoi edhe në aspektin ndërkombëtar, po ashtu edhe atë politiko-shoqëror në kushte tejet të vështira. Ndërsa Bujar Dugolli ka thënë se rektori Ejup Statovci ishte në ballë bashkë me studentët dhe një shtyllë e madhe e përkrahjes që e pati lëvizja e studentëve. Nga pjesëmarrësit u përkujtua edhe rektori Kelmendi i cili ishte pasues i rektorit Statovci, gjithashtu edhe veprimtari dhe lideri studentor nga Mitrovica, Ali Ahmeti, për kontributin e dhënë për studentët, universitetin dhe shoqërinë.



## Mavraj me unionet e studentëve nderon Ali Ahmetin, Artim Jasharin dhe Sedat Kabashin

Muhamed Mavraj, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, me rastin e kujtimit të protestës së 1 titorit të vitit 1997, ka bërë homazhe te varri i veprimtarit e liderit studentor nga Mitrovica, Ali Ahmeti, i cili ndëroi jetë një vit më parë. "Nuk të harrojmë Ali Ahmeti! Urime 1 totorin! Dhe faleminderit për gjithfarë që bërë për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! (Me unionet e studentëve të Mitrovicës 1997-99, babanë e

Aliut, gruan dhe fëmijët, motrat, vëllezërit, shokët)", ka shkruar Mavraj në "Facebook". Po ashtu, Mavraj ka bërë homazhe edhe te varri i Artim Jasharit. "Nuk të harrojmë trim Artim Jashari! Urime 1 totorin dhe faleminderit për gjithfarë bërë për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! (Në Korishë, me familjen e ngushtë e të gjerë të Sedatit, Laurën me djemtë, motrat, vllaznitë, ish-Unionin e Prizrenit e plot bashkëluftëtarë. I falënderojmë fort për pritjen e dashurinë për Sedatin!)", ka shkruar Mavraj.

kontributin e tij në demonstrata. "Nuk të harrojmë Sedat Kabashi! Urime 1 totorin dhe faleminderit për gjithfarë bërë për Kosovën, në demonstrata e gjatë luftës! (Në Korishë, me familjen e ngushtë e të gjerë të Sedatit, Laurën me djemtë, motrat, vllaznitë, ish-Unionin e Prizrenit e plot bashkëluftëtarë. I falënderojmë fort për pritjen e dashurinë për Sedatin!)", ka shkruar Mavraj.



Studentore, e cila filloj më 1 totorit të vitit 1997 me atë qe njihet si protestat e 1 totorit, ishte ndëri gjarjet më të rendësishme historike në Kosovë në fund të shekullit XX. "Kjo lëvizje u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytatarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotore të luftës për liri dhe pavarësi. Në këtë 26-vjetor kujtojmë me respekt aktivistët dhe luftëtarët e lirisë nga radhët e kësaj lëvizje që ranë në altarin e lirisë, si dhe kontribuuesit e shumtë, studentë dhe profesorë të Universitetit të Prishtinës, që u rreshtuan në rrugën e drejtë të lirisë së Kosovës. Përkujtimi i këtyre datave historike duhet të na shërbëjë përmotivim edhe më të madh, për ta dashur edhe më shumë universitetin, kombin dhe shtetin", ka thënë Dugoll. Edhe Driton Lajçi, një nga drejtuesit e kësaj lëvizje, ka thënë

se është emocion i veçantë dhe krenari e madhe kur kujton atë elan të madh studentor. "Krenar dhe me fat që kam qenë një nga drejtuesit e saj. Slogani ynë kryesor ishte 'Universiteti, Kosova, studentët, sot, nesër vonë'. Ndërsa për brezin e gjeneratës sime, sot, nesër e përgjithmonë faleminderit për kontributin e dhënë për Universitet, liri dhe nderim studentëve të rreshtuar në UÇK që ranë për lirinë e Kosovës. Sot të përfitojmë nga modeli i atdhedashurisë që praktikuam ne dhe ta zbatojmë në objektivat e sotme. Që të kemi Universitet dhe arsimim cilësor dhe ndërlidhje ndërmjet arsimit dhe ekonomisë, ndërsa ndërhyrjeve të Serbisë në Kosovë t'i përgjigjemi me unitet dhe mbështetje ndaj atyre që po sakrifikojnë duke e mbrojtur shtetin e Kosovës çdo ditë të lumit Zot", ka theksuar Lajçi.

Edhe Muhamed Mavraj, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore, ka thënë se më 1 totorit është mposhtur frika e Kosovës, ka rënë miti i frikës dhe secili shqiptar

aktiv. Efektet e këtij veprimi të vendosur të studentëve ishin të menjëherëshme. Me këtë lëvizje studentore u bë mjaftueshmë e quartë se çdo formë e rezistencës paqësore, sado e organizuar në mënyrë të përkryer, përballë regjimit okupues serb, do të ngelë pa efekte. Faktori ndërkombëtar që kishte interesim për zhvillimet në Ballkan dhe në Kosovë nga kjo lëvizje studentore e kuptoi seriozitetin e situatës shpërthyese dhe quartësoi pozicionet e veta karshi palëve rivale. Edhe faktori vendor u ndërgjegjësua se lëvizja paqësore e rezistencës nuk mund të prodhonte më asnjë efekt konkret në përbushjen e platformave politike të shqiptarëve të Kosovës ndaj dhe



totorit ushqejnë një impuls krenarie, natyrisht, por na bëjnë t'i kujtojmë shumë shokë tanët dëshmorë", ka theksuar Mavraj, i cili në përvjetorin e 25-të, një vit më parë, të kësaj ngjarje historike, kishte vizituar në Hagë çlirimtarët të cilët po mbahen në paraburgim, duke theksuar se në këtë përvjetor askush më shumë sesa këta nuk meriton respektin dhe përkrahjen.

**"Kjo ngjarje duhet të shënohet në tekstet shkollorë dhe të kujtohet nga gjeneratat e reja..."**

Ish-rektori i Universitetit të Prishtinës dhe një nga pedagogët pjesëmarrës në protestën e 1 totorit 1997, Ibrahim Gashi, ka theksuar për gazeten "Epoka e re" se protestat studentore të vitit 1997, veçmas ajo e 1 totorit, paraqesin nivelin më të artikuluar

të joziqencës aktive në lëvizjen e deritashme politike të shqiptarëve të Kosovës. "Shumë studiues e cilësuani atë si zëvendësim të lëvizjes paqësore pasive me një veprim joziqë aktiv. Efektet e këtij veprimi të vendosur të studentëve ishin të menjëherëshme. Me këtë lëvizje studentore u bë mjaftueshmë e quartë se çdo formë e rezistencës paqësore, sado e organizuar në mënyrë të përkryer, përballë regjimit okupues serb, do të ngelë pa efekte. Faktori ndërkombëtar që kishte interesim për zhvillimet në Ballkan dhe në Kosovë nga kjo lëvizje studentore e kuptoi seriozitetin e situatës shpërthyese dhe quartësoi pozicionet e veta karshi palëve rivale. Edhe faktori vendor u ndërgjegjësua se lëvizja paqësore e rezistencës nuk mund të prodhonte më asnjë efekt konkret në përbushjen e platformave politike të shqiptarëve të Kosovës ndaj dhe

gradualisht pas kësaj lëvizjeje po hapej perspektiva për një strategji të luftës së armatosur midis palëve. Krejt në fund, me të drejtë mund të konstatojmë se protestat studentore të vitit 1997 janë hallka e fundit e lëvizjes së rezistencës paqësore, e cila arriti të lidhet, mbasë edhe të shndërrohet në hallkën e parë të rezistencës së armatosur të UÇK-së, e cila e vitalizoi, i dha shpirt dhe e sendërttoi platformën e Kosovës për çlirim dhe shtet të pavarur. Pikërisht këtu qëndronte rëndësia e kësaj lëvizjeje historike studentore dhe si e tillë do të zëri vend në historinë e re të Kosovës", ka thënë Gashi.

Ai ka theksuar se Universiteti i Prishtinës mund të cilësohet jo vetëm si truri, por edhe si forca kryesore vepruese e lëvizjes politike kosovare që mundësoi në të gjitha etapat e saj sendërtimin e platformës kombëtare për liri dhe shtet.

Edhe profesori dhe ish-rektori i UP-së, Arsim Bajrami, një nga organizatorët e kësaj proteste, ka thënë për gazeten "Epoka e re" se protestat studentore të vitit 1997 ishin një momente kthuese dhe fillim i thyerjes së Serbisë dhe ish-Jugosllavisë në Kosovë. "Këto protesta theyn mitin e pamposhtmërisë së Serbisë, duke i dhënë fund nënshtrimit dhe rezistencës paqësore si një kushtim lirie, që u bë realitet me luftën heroike të UÇK-së", ka thënë ai.

Bajrami ka thënë se duke kujtuar 26-vjetorin e kësaj proteste madhështore, kur studentë e profesorë u bënë bashkë kundër robërisë, sot kujtojmë me pietet rektorin e atëhershëm të UP-së, Ejup Statovci dhe udhëheqësit e studentëve. "Në mënyrë të veçantë ata që rënë në altarin e lirisë në luftën çlirimtarë së cilës iu bashkëngjiten. Kujtojmë Edmond Hoxhën, Zahir Pajazitin e Hakif Zejnnullahun me shokë, që ishin në reshtat e parë të kësaj proteste, e pastaj edhe luftës së lavdishme të UÇK-së. Si një nga organizatorët e kësaj proteste bashkë me kolegët dhe studentët e Fakultetit Juridik jemi krenarë që këto protesta frymëzuan heronjtë dhe martirët që dhanë jetën në shërbim të atdheut, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Kjo ngjarje duhet të shënohet në tekstet shkollorë dhe të kujtohet nga gjeneratat e reja si akt sublim i fillimit të procesit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", është shprehur profesor Bajrami.

# Skenari i përfitimit të Albin Kurtit mbi gjakun dhe fatkeqësitë e të tjerëve

**Shkruan: Hisen BERISHA**

Ja edhe një rikonfirmim nga ky i sëmuri nga dëliri i pushtetit dhe pengu i agjendave kundër shtetit të Kosovës.

Policia i vrarë është veç viktima e radhës së këtij të çmendurit nga milosheviqizmi.

Deri me tanë Kosova i numëron pesë (5) të vdekur nga ambicjet e tija për pushtet. Nuk duroj gjatë dhe mbi gjakun e rreshterit Bunjakut dhe dhimbjen e zonjës Bunjakut, tre fëmijëve jetim, prindërve e bashkëpunëtorëve në Policinë e Kosovës, por edhe mbarë kombit që u pikëlluan me vdekjen e tij, e deklaroi se qëllimi i skenarit në Veri, të koordinuar me Vuçiqin përmes Radojçiqit, ishte rritja e përqindjes së përkrahjes për të dhe ambicia edhe për një mandat për ta quae përparrë tradhtinë ndaj vendit e popullit.

Në ketë mënyrë përfitoi mbi gjakun e Arben Xheladinit, Mon Balajt, vëllezërve Dehari dhe së fundmi Afrim Bunjakut, e dy të plagosurve për të cilët asnjë përkujdesje nuk

tregoi, ngase ata nuk janë të mire dhe as heronj, sepse nuk kanë vdekur për kauzën e tij elektorale. E për edukatën e tij dhe shkollën politike që përfaqëson vetëm "shqiptari i vdekur është i mirë! E hero, mund të shpallet njeriu që bën heroizëm edhe për së gjallit siç janë policët e plagosur.

Edhe policëve që ishin në operacion iu takon çmimi presidencial përtrimëri, si standard kushtetues. Por, jo qëllimi i këtij janë viktimat, mbi gjakun e të cilëve e rritë votën, siç edhe e kam theksuar në analizën time pas aksionit dhe siç po e deklaron ky, ende pa u tharë lotët e familjes për Afrimin, as dy policët tjerë të plagosur, se: "besimi në qeverinë tonë është mbi 55 për qind, më i lartë në Ballkan – ecim bashkë drejt mandatit të ri!"

Ndërsa fëmijët e të vrarëve jetojnë në mjerimin e përgjithshëm, duke iu thurur himne shpura qeverisëse kriminale e kuislinge e Kosovës.

Ky është njëri pa Zot, pa dinjitet e pa ndërgjegje, se edhe fjala e shenjtë na udhëzon që "të mos përfitojmë mbi fatkeqësinë e



tjetrit".

Viktimat e çmendurisë tënë, historia do i ruaj si heronj të sakrificës së tyre për shtetin, lirinë të ardhmen e fëmijëve tanë, sepse

me atë motiv e bënë. Por, ty do të mallkoj historiën përrrethanat që krijove, që ata të humbin jetët e tyre. E kjo meqë ende nuk ka sistem drejtësisë, që do iu akuzonte

si vrasës politik.

Shpresoj në hetimin nga Kongresi e inteligenca amerikane të procesit të dialogut dhe ju do merrni dënimin e popullit dhe historisë.

## Heronjtë i dua të gjallë

**Shkruan: Izmi ZEKA**

Një natë e errët kur Prishtina vlonë nga zhurma e këngëve e shëtitjet sa ngaherë të kapin drithërimet dhe shpirtit të vlon nga buzagazi i shpirtit të lirë i jetës që nuk kthehet mbrapa. Në anën tjetër televizionet me politikanë që krijon përshtypjen se jeta lindi këtu mes nesh dhe të tjerët janë merimangat që shtrijnë trupin ngado e kudo ku gjejnë vend. Atje përskaj Kosovës netët kanë dhimbje e herë-herë shpresë.

Sa herë që zgjohem këto ditë nuk e di pse ama kam frikë nga paqja e vyshkur e sidomos kur shohë fëmijët e dalldisur duke lozur me buzqeshjen e panda. Kam frikë nga paqja që as vet nuk e di pse. Ndoshta pse kam dëgjuar për jetën e djeshme, për nënët që mbetën pa fëmijë, baballarët pa familjar, ndoshta pse unë jam frikacak e rritur në paqe dhe të djeshmen e kam vetëm të dëgjuar dhe kujtim i hidhur.



Ndoshta kur të bëhem e zonja edhe unë si të tjerët nuk do ta ndjejë frikën ama tash nuk kam shpjegim pse kjo po ndodh me mua.

Harrova të ju them se babin tim e hëngri paqja. Ai ishte ai polici me plot jetë, ku ekranet, portalet ishin të mbushur me fotografinë e

tij. Sa herë e pyesja për të djeshmen ai vetëm heshtke. Thua se diçka kishte në shpirt.

Atë ditë që iku unë isha në gjumë. E më mirë tanë po them mos të zgjohesha fare. Kam frikë nga paqja. Mendohem e them me vete e pse babai im të vdiste kur liria i kishte rrënjet në gjak e pse,

pse që nuk po mundem të gjejë përgjigje ka disa ditë, Nëna më shikon shpesh dhe nuk flet fare. Nga tradita loti nuk i shihet. Paçka edhe nëse qan e bërtet me të madhe them shpesh. Kulla u shemb për ne e nëna ime as edhe një zë nuk e lëshon, as edhe kur erdhë babai me plumb në ballë. Unë qaja, bërtitja pa nda sikur fëmijët 5 vjeçar edhe pse sot i kam të 14-ta. Unë jam ajo vajza që fola për heroin tim, atë ditë kur të gjithë më shikonit. Ama ju ndoshta nuk e dinit që babai im ishte edhe në të gjallë heroin im. Për atë qava kur fola dhe kur i thash lamtumirë.

Kisha dëgjuar dhe lexuar se si Drenica u dogj flak gjatë luftës, kisha par dokumentare për fëmijët e vrarë, për baballarët që u dogjën të gjallë në shtëpitë e tyre nga forcat serbe. Më kuptioni tanë e kam në shpirt dhe po ndjejë se neve na morën diçka nga zemra e që nuk po kam fuqi ta shpjegoj. Të lexosh, të dëgjosh qenka ndryshe. Tani që më preku

shpirtin ju të tjerët që i keni baballarët nuk e kuptioni. Ju mund të flisni, mund të shkruani por shpirtin e keni të qetë. Atë ditë kur babin e pash të shtrirë mu dukë që toka u nda në dysh. Prandaj kam frikë nga paqja. Nuk e dua këtë paqe që ma mori babanë. Them të drejtën unë doja që heroin tim ta kisha të gjallë e jo te vdekur. Ai ishte babai im më kuptioni. Ai më ledhatonte faqet, më puthëtë çdo mëngjes. Ai këndonte këngë me sharkinë që e la në mur. E kishte amanet nga babai i tij. E tani kush do të më thotë eja vajza ime, kush do të më këndoje këngën e baresës çdo mëngjes, kush do të vijë në shkollë e pesat e mijë ti shikoj. Unë e desha heroin tim të gjallë buzagaz. Nuk i dua heronjtë të vdekur në paqe. Heronjtë i dua të gjallë. Ndoshta veç të vdekur janë heronj. Jam ende e re dhe plot shpresë. E dua jetën. Babai më iku atë mëngjes përskaj Kosovës. Më kuptioni njerëz, ai nuk është më. Dallëndyshja e tij mbeti pa heroin e gjallë.

## Basha: Vuçiqi është kokë e këmbë brenda skenarit të sulmit terrorist në Banjskë

**TIRANË, 1 TETOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, ka komentuar sulmin terrorist në Kosovë javën e kaluar. Ai ka thënë se presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, është kokë e këmbë brenda këtij skenari. "Duhet të pranojmë dhe komunikojmë se ajo që ndodhi në Kosovë nuk është një incident i izoluar.

Armatimi është futur në Kosovë prej muajsh, me qëllim për të provokuar një skenar që duket spontan për është i parapërgatitur, një skenar shumë i ngjashëm me atë që ndodhi në Krime në vitin 2014. Asgjë nuk mund të ndodhë pa ndihmën dhe miratimin e segmenteve shtetërore në Serbi. Pyetja që shtrohet për

Vuçiqin është se deri ku shkon pjesëmarrja e tij në këtë skenar lufte, jo vetëm për Kosovën por për Ballkanin. Është bashkautor apo një president i marrë nga mashat e Rusisë, duke filluar nga Vulini? Deklarata e Radojçiqit lë pak hamendësim që Vuçiqi është kokë e këmbë brenda në këtë skenar", ka thënë Basha.



## Sveçla dhe Hoxha: Autorët e sulmit të 24 shtatorit në veri u përgatitën në pronën e Radoiqiqit

**MITROVICË, 1 TETOR** - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, së bashku me drejtorin e Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ku kanë prezantuar të dielën në një konferencë përmes pamje që, sipas tyre, dëshmojnë dorën e shtetit serb në sulmin terrorist të 24 shtatorit në Banjskë të Zveçanit. "Ky organizim terrorist kishte vetëm një qëllim: aneksimin e veriut të Kosovës", ka thënë Sveçla.

Ai ka thënë se provat dëshmojnë "përgatitjet e këtij grapi nga shteti i Serbisë në qendrat zyrtare të trajnimeve". "Në këtë tentim aneksimi janë angazhuar drejtëpërsëdrejti presidenti Aleksandër Vuçiç, ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Millosh Vuçeviq dhe shefi i komandës i ushtrisë serbe, Milan Mojsiloviç", ka thënë Sveçla, duke shtuar se terroristët ishin përgatitur në pronën e Millan Radoiqiqit. Pamjet, siç ka thënë ai,

dëshmojnë se në drejtim të policisë kishte të shtëna me armë të kalibrave të rëndë edhe pas vrasjes së policit Afrim Bunjaku. "Përgatitjet, trajnimet dhe ushtrimet e këtij grapi janë bërë afër Jagodinës si dhe në Kopaonik. Të gjitha këto pamje janë siguruar nga dronët e grupit terrorist që i kemi konfiskuar", ka thënë Sveçla, duke shtuar se provat janë të pakontestueshme dhe se tani "është i domosdoshëm



dënim i dhe sanksionimi i këtij sulmi terrorist nga faktori ndërkombëtar". Ndërsa drejtori i policisë, Gazmend

Hoxha, ka prezantuar në detaje armatimin e konfiskuar pas sulmit terrorist në Banjskë të Zveçanit.

## Fondi 'i pavërejtshëm' për veriun

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Tash e dhjetë vjet për komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës janë grumbulluar mbi 14 milionë euro, të destinuara përmes zhvillimit ekonomik dhe investimeve në infrastrukturë, por zona vazhdon të mbetet vatrë tensionesh. Paratë janë pjesë e të ashtuquajturit Fond Zhvillimor i Mirëbesimit, përmes cilin Kosova dhe Serbia janë pajtuar në vitin 2013, në kuadër të bisedimeve përmes normalizimin e marrëdhënieve.

Qëllim i këtij foni është t'i zhvillojë dhe integrojë komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, ku popullata serbe, që nga pasluftha më 1999, nuk u bindet vendimeve të institucioneve të Kosovës, por strukturave paralele serbe që funksionojnë nën dirigimin e Beogradit zyrtar.

Paratë e Fondit grumbullohen nga importi i mallrave përmes pikave kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak, të cilat gjenden në veri të Kosovës.

Nga Bashkimi Evropian, që ndërmjetëson bisedimet Kosovë-Serbi, kanë thënë se nga ky fond janë realizuar projekte të ndryshme - nisur nga infrastruktura rrugore deri te qendrat kulturore dhe rekreative. Por, nga anketat që "Radio Evropa e Lirë" realizon kohë pas kohe me qytetarët në veri, qytetarët kryesisht shprehen të shqetësuar përmes situatës politike dhe kundërvendimeve që marrin institucionet e Kosovës.

Si pasojë e mosbindjes, por edhe



ndikimit të strukturave serbe, ata nuk paguajnë as rrjmë, as ujë që nga pasluftha. Vazhdojnë t'i kenë shkollat dhe spitalet që funksionojnë nën sistemin e Serbisë.

Shumica e bizneseve në zonë, po ashtu, nuk janë të evidentuara dhe nuk paguajnë asnjë detyrim ndaj institucioneve të Kosovës tash e 24 vjet.

Nga nëntori i vitit të kaluar serbët e kësaj pjese kanë braktisur edhe institucionet e Kosovës në të cilat kanë marrë pjesë si pasojë e një vendimi të Qeverisë së Kosovës përmes t'i riregjistruar makinat me targa ilegale serbe.

I banuar me rreth 50 mijë qytetarë, veriu i Kosovës është shpesh edhe skenë e përlleshjeve të dhunshme. Të fundit kanë ndodhur më 24 shtator kur grupe të armatosura serbësh kanë sulmuar Policinë e Kosovës, duke vrarë një polic.

Dragisha Mijaçiq, drejtor i

Institutit përmes zhvillimit ekonomik territorial (INTER), me seli në Zubin Potok, ka thënë përmes "Radion Evropa e Lirë" se Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit nuk ka mbledhur mjete të mjaftueshme financiare që do të krijonin parakushte përmirësimin e jetesës së qytetarëve në veri. "Kur investioni para në mëjediset lokale, gjithmonë ka përfitme. Por, nuk ka pasur efekte që mund t'u matet. Përdhjetë vjet janë investuar 14 milionë euro. Ato janë aq pak para saqë nuk mund t'u arrijnë kurrfarë rezultati domethënës", ka thënë Mijaçiq.

Disa projekte kanë dhënë rezultate të mira, por "shumë prej tyre nuk janë përfunduar dhe nuk kanë dhënë kurrfarë rezultatesh", ka thënë ai, pa specifikuar më shumë. Por, përmes Haki Shattrin, ekspert i çështjeve ekonomike, projektet e ndërtuara nga foni në fjalë kanë

pasur efekt në mirëqenien e qytetarëve lokalë. Sipas tij, janë strukturat paralele, të udhëhequra nga Serbia, që nuk i lejojnë qytetarët t'i pranojnë publikisht rezultatet. "Atje janë të pranishme strukturat paralele, të ndikuara nga Beograd, të cilat i pamë publikisht ditët e fundit. Por, në jetën e përditshme të qytetarëve lokalë kanë qenë të pranishme çdo kohë, duke iu bërë presion dhe duke i frikësuar. Prandaj, qytetarët janë në hamendje, në dilema se kah t'ia mbajnë, sepse i kanë frikësuar vazhdëmisht që t'u mos punojnë, t'u mos bashkëpunojnë dhe t'u mos e njohin shtetin e Kosovës", ka thënë Shatri. Ai ka theksuar se krijimi i këtij foni madje i ka favorizuar katër komunat në veri, pasi asnjë komuna njerëz nuk e gjëzon një fond t'u tillë t'u veçantë.

Pikëpamjet politike, të ndikuara nga Beograd, pengojnë

përpamin e veriut, ka thënë edhe profesori i ekonomisë në Prishtinë, Muhamet Sadiku. "Përkundër investimeve nga mjetet e ekzekutivit, por edhe nga burimet e jashtme, në këtë pjesë të vendit dominojnë pikëpamje destruktive politike dhe ato janë pengesë e madhe përmes krijuar përparmi përgytetarët lokalë", ka thënë Sadiku.

### Ku dhe sa është investuar?

Bordi menaxhues i Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit përbëhet nga përfaqësues të BE-së, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe përfaqësues të komunave veriore. Nga Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë kanë bërë me dije se nga vlera e përgjithshme e Fondit, prej 14 milionë eurosh, mbi 6.9 milionë euro janë shpenzuar përmes projekteve të komunën e Mitrovicës së Veriut, mbi 3 milionë euro në komunën e Zveçanit, mbi 2.5 milionë euro në komunën e Zubin Potokut dhe mbi 2 milionë euro në komunën e Leposavikut.

Investimet, sipas BE-së, përfshijnë ndërtim të riparim të infrastrukturës rrugore, ndërtim të objekteve kulturore, sportive dhe rekreative, mbështetje përmes marrjet e vogla dhe të mesme, blerje të pajisjeve mjekësore dhe tjetra.

Përvec mjetave nga Fondi Zhvillimor i Mirëbesimit përmes komuna, edhe Qeveria e Kosovës ka ndarë mbi 16 milionë euro përmes projekteve buxheti i sivjetmës.

## Osmani: Serbia duhet ta dijë se do të përballet me një popull të gatshëm përmes mbrojtur lirinë me çdo kusht

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Serbia duhet ta dijë se do të përballet me një popull që është i gatshëm ta mbrojtë lirinë me çdo kusht. Kështu ka deklaruar e para e shtetit në një intervistë përmes mediumin italian "La Repubblica".

Osmani ka thënë se Serbia kreu një akt agresioni të dielën e shkuan, ku një grup prej 30 personave terroristë serbë

sulmuan Policinë e Kosovës. Nga ky sulm mbeti i vdekur rreshteri Afrim Bunjaku dhe tre terroristë serbë. "Serbia duhet ta dijë se do të përballet me një popull të gatshëm përmes mbrojtur lirinë me çdo kusht dhe se NATO është me ne", është shprehur presidentja Osmani në një intervistë përmes mediumin italiane.

Po ashtu, Osmani ka thënë se Serbia është duke vepruar

shumë më ndryshe se ajo që është parë në 25 vjet e fundit. "Ka prova të pakundështueshme. Serbia ka kryer një akt agresioni me datën 24 shtator dhe po përgatitet të kryejë një akt tjetër duke përforuar forcët e armatosura dhe artillerinë në kufirin me Kosovën. Është diçka ndryshe nga ajo që kemi parë në 25 vjet e fundit. E paprecedentë", ka thënë Osmani.



## "Sharr Travel" nderohet me çmimin si agjencia turistike më e mirë mbarëshqiptare 2023

**TIRANË, 1 TETOR** - Kompania turistike "Sharr Travel" është vlerësuar në Tiranë me çmimin agjencia turistike më e mirë mbarëshqiptare. Ky organizim për herë të parë në Shqipëri është organizuar nga "Albanian Excellence dhe Travel Magazine Balkans". Kryetari i Lezhës, Pjerin Ndreu, ia ka dhënë çmimin

drejtorit të kësaj agjencie, Ruzhdhi Kurtishajt. Me këtë rast, Kurtishaj e ka falënderuar për besimin që qytetarët ia kanë dhënë ndër vite agjencisë "Sharr Travel". "I nderuar të pranoj çmimin e veçantë 'Agjencia më e mirë turistike mbarëshqiptare 2023' nga kryetari i Bashkisë së Lezhës, njëkohësisht mik shumë i mirë imi dhe i të "Sharr Travel".



## PDK-ja nuk pajtohet me pushtetin për numrin e të punësuarave në Kosovë

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se gjatë mandatit të tij si ministër ka dyfishuar numrin e të rinjeve të punësuar. Murati ka shkruar në "Facebook" se për 30 muaj janë mbi 32 mijë të reja e të rinj që kanë filluar punën. Ai ka thënë se asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë masa e mbështetje për punësimin e të rinjeve sikurse me qeverinë aktuale. "Gjithsej të rinj të punësuar të moshës 15-24 në fillim të vitit 2021 ishin 28 293 persona. Kurse në fund të korrikut 2023, numri i tyre është më i madh se 32 mijë të reja e të rinj që kanë filluar punën. Diçka e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë në historinë e shtetit tonë. Sepse asnjëherë më parë nuk ka pasur kaq shumë masa e mbështetje për punësimin e të



rinjeve sikurse me qeverinë tonë", ka shkruar Murati. Me këto statistika nuk është pajtuar Partia Demokratike e

Kosovës (PDK). Koordinatori për Financa në Kabinetin e Qeverisjes së Mirë të PDK-së, Arben Mustafa, ka shkruar në "Facebook" se në

fund të vitit 2022, krahasuar më 2021, numri i të papunëve sipas ASK-së është zvogëluar për 38 mijë 298 persona. Sipas tij numri i

të punësuarve është rritur vetëm për 8 mijë 789 persona. "Pra, shtrohet pyetja ku mbeten ata 29 509 persona që nuk po figurojnë më si të papunësuar, por as si të punësuar?! Përgjigja më e mundshme është se ju kanë bashkëngjitur karvanit të migrimit sepse kanë humbur shpresat përnjë jetë më të mirë në Kosovë. Në anën tjetër, ministri i Financave po i paraqet disa statistika administrative të punësimit, të zbuluara nga vetë kjo Qeveri, sipas të cilave në Kosovë qenka duke lulëzuar punësimi i të rinjeve! Duke ndenjur i mbyllur në zyrë ndoshta edhe i beson këtij tregimi, por nuk besoj që do ti besonte nëse do të dilte nga pak prej zyrës dhe ta shihte dinamikën e ekonomisë së vendit. Mos të harrojmë, rritja ekonomike në periudhën e fundit është vetëm 2 për qind", ka shkruar Mustafa.

## ASK-ja: Më shumë të punësuar me pagë primare dhe sekondare në gusht të 2023-s sesa një vit më parë



**PRISHTINË, 1 TETOR** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Statistikat Administrative të Tregut të Punës përmes muajin gusht 2023. Në njoftimin përmes medie, ASK-ja ka bërë me dije se në muajin gusht 2023 të punësuar me pagë primare ishin 370 115 persona që, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Gusht 2022, që ishin 360 164), ka rritje për 9 951 persona, ose 2.8 për qind të

punësuar me pagë primare. Grupmosha me më së shumti të punësuar me pagë primare ishte 25-34 vjeç. "Në muajin gusht 2023 të punësuar me pagë sekondare ishin 17 046 persona, ku krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Gusht 2022, që ishin 15 851), ka rritje për 1 195 persona ose 7.5 për qind të punësuar. Grup-mosha me më së shumti të punësuar me pagë sekondare ishte 35-44 vjeç",

thuhet në njoftim. Punësimi më i theksuar përmes muajin gusht ishte në këto aktivitete: administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social (24.5 për qind), tregti me shumicë dhe pakicë (20.7 për qind), prodhim (10.8 për qind) etj. Këto të dhëna bazohen në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK).

## Përdorimi i kartelës bankare, trend në rritje edhe në Kosovë

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Përdorimi i kartelës bankare përmes kryer pagesa dhe shërbime ka shënuar rritje përmes 3.6-përqindësh në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo mënyrë e pagesës është duke u vlerësuar më e lehtë, më e sigurt dhe më e shpejtë. Përveç kësaj, nga Shoqata e Bankave e Kosovës kanë thënë se kartelat bankare janë thëlbësore përmes blerjet online dhe udhëtimet ndërkombëtare.

Ish-kryetari i Odës

Ekonome të Kosovës, Safet Gérxhaliu, ka vlerësuar se avancimi në aspektin digital dhe atë të pjekurisë së një shteti është shfrytëzimi sa më i madh i kartelave. Gérxhaliu ka potencuar se përdorimi i kartelës bankare përmes kryer shërbime është ndër format më stabile dhe të sigurta, derisa shtoi se pagesat cash lënë hapësirë përmes falsifikimit dhe kontrabandë. "Është ndër format më të sigurta, më të shpejta dhe më stabile. Sa më

tepërt qarkullim të cashit nëpër duar të qytetarëve, shumë më tepërt ka informalitet dhe kontrabandë dhe kjo e dëmonon Kosovën", ka thënë Gérxhaliu përmes "KP". Ndërsa nga Shoqata e Bankave të Kosovës kanë thënë se pagesat digitale reduktivë fenomenin e falsifikimit të parasë dhe eliminonjë nevojën përmes mbajtur sasi të mëdha parash. Në anën tjetër nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) kanë thënë se të gjitha



brendet e kartelave të lëshuara në Republikën e Kosovës janë ndërkombëtare dhe, si të tilla, lëshohen sipas standardeve më të mira ndërkombëtare të sigurisë.

# Isak Guta, vigan i diasporës!



Shkruan: Imer Xhemail LLADROVCI

Fizika kuantike ka zbuluar se shkëputja e një trupi nga një tjetër nuk do të thotë ndarje përfundimtare, absolute e tyre. Këta dy trupa mund të largohen nga njëri-tjetri në distanca të mëdha astronomike që maten me vite drite dhe përsëri të japidh dhe marrin me njëri-tjetrin me një shpejtësi që e kalon atë të dritës, pra të ushtrojnë ndikim reciprok në kuptimin e njëkohshmërisë. Shkurt, kështu largesa kthehet në një madhësi krejt të papërfillshme, inekzistente. Ky është një ligj universal që vlen edhe në jetën njerëzore, ndaj dhe interesimi ynë për këto njohuri që lidhen drejtpërdrejt me botëkuptimin tonë. Edhepse dijet e kësaj shkencë gjejnë zbatim të gjerë në jetën tonë të përditshme, që është cilësisht krejt e ndryshme nga ajo e brezave të shkuar, fizika kuantike përsëri është trajtuar si një gjysmëshkencë, disi si një lloj dije që qëndron mes fikcionit dhe realitetit. Me fjalë të tjera, herë pas here është thënë hapur se ajo është më shumë fantazi sesa shkencë. Vetë Albert Ajnshtajni (Albert Einstein) që në vitin 1905 e mori cminin Nobel për kontributin e tij në lëminë e optikës kuantike e shkoi deri në fund të jetës së tij këtë teori me dyshim dhe mosbesim. Ai që me gjithë jetën e tij kishte qenë kundër cdo lloj autoriteti, përi ironi të fatit, vetë u kthyte në një autoritet frenues. Ajnshtajni besonte ne një botë

deterministe që nuk lë hapësirë për rastësinë, të cilën sot fizikanti Anton Cailinger e konsideron si gjënë më të cmueshme në shkencën bashkëkohore. Nuk thuhet kota se e vërteta vonon, por vjen një ditë dhe ajo triumfon.

Vitin e kaluar Komiteti i Nobelit në Stockholm u kujtua më në fund për kontributorët më të mëdhenjë të kohës sonë në këtë lëmi, për amerikanin Xhon Klauzër (John Clauser), francezin Alen Aspekt (Alain Aspect) dhe austriakun Anton Cailinger (Anton Zeilinger), të cilëve u dha Nobelin 2022 përfizikë. Tanimë përfundimisht u bë e qartë gjithçka: në rastin e fizikës kuantike nuk bëhet aspak fjalë përfantazi, por për shkencë të mirëfilltë, për një shkencë që e ndryshon botëkuptimin tonë.

Dikush mund të thotë ç'lidhje ka fizika kuantike me fatin e një shqiptari të mërguar. Në shikim të parë asgjë, por nëse cështjen e shohim më thellë, nga kënvështrimi i dijes, shumë, jashtëzakonisht shumë. Jeta e njeriut, edhe ajo e mërgimtarit nuk del Jashtë kuadrit të ligjeve të natyrës, sepse njeriu dhe natyra përbëjnë një unitet, njeriu është natyra, pjesë e saj. Fati jetësor i Isak Gutës ishte i tillë që mund të ilustrojë bindshëm këtë ligji universal të ndarjes dhe njëkohësisht të kontaktit të vazhdueshëm të pjesës me tëresinë, prej të cilës ajo është shkëputur, siç e dimë

nga jetëshkrimi i tij, përmes dhunës së jashtme. Jeta e tij është një udhëtim i gjatë e i ngatërruar drejt Itakës që mori fund pak ditë më parë. Ai u kthyte aty, në vendin që ai e deshi me gjithë shpirt. Isak Guta vërtet fizikisht për një gjysmëshekulli të tërë jetoi larg atdheut, por me zemër ishte gjithmonë brenda tij. Ai u lind në këtë vend dhe tanë që nuk është më fizikisht në mesin tonë eshtrat e tij pushojnë në këtë dhe. Jetoi larg atdheut, por atdheun e kishte brenda tij, thellë në zemër. Shqipëria për të ishte atdhe shpirtëror që kurrë nuk mund të braktisej, pavarësisht sesa larg saj mund të ishte ai.

Këtë bindje të tij të palëkundshme më në fund e dëshmojnë librat e tij që shkroi në vitet kur Kosova më nuk ishte nën sundimin serb. Një pjesë të krijimtarisë së tij letrare dhe aktivitetit kulturor ia kushtoi aktorit me famë botërore Aleksandër Moisiu, me të cilin, veç artit të madh, e lidhte edhe fati i mërgimtarit. Isak Guta mishëron tipin e shqiptarit që është i lidhur me mijëra fije të padukshme me atdheun e tij. „Fati i popullit tim është fati im“ thoshte Pjetër Bogdani. Kjo thënë i shkon shumë jetës së Isak Gutës. Ai jetoi për këtë vend dhe gjithë energjitet shpirtërore i vuri në shërbim të atdheut, edhepse jo rrallë kontributi i tij nuk u kuptua në

masën e duhur.

Por kjo gjë nuk ndodhë për herë të parë dhe vetëm me të, historia jonë kombëtare dhe ajo botërore njeh shumë raste të tilla, vetë fizika kuantike i ka trajtuar në njëfarë mase paraardhësit e saj gjenalë si sharllatanë, ndaj dhe presidenti amerikan Xhon Kenedi i përballur me këtë përvojë gjithnjëzore thoshte: mos shiko se ç'bën vendi yt për ty, por bëje atë që ti duhet ta bësh për të. Bindja ime është se Isak Guta pikërisht këtë gjë ka bërë. Ai ka punuar gjithmonë për Shypninë, ndaj dhe ne e nderojmë e i përkulemi punës së tij.

Isak Guta e vlerësonte shumë traditën shqiptare, sepse ai gjente pikërisht aty forcën për të qëndruar i pathyer në vështirësi dhe frymëzimin për të shkruar librat e tij.

Shqiptari kurrë s'u përkul para vështirësive, por qëndroi krenar në furtunën e shekujve dhe u bë edhe më i fortë. Njëri nga këta shqiptar, pikërisht në këtë aktivitet përkujtimor është momenti të thuhet ajo që nuk i është thënë asnjëherë, ishte edhe vetë Isak Guta, jeta e të cilët përbën një frymëzim të madh për të gjithë ne.

Me Isak Gutën u njoha në vitin 2006 në Berlin, në kuadër të një aktiviteti të diasporës sonë në Gjermani që i kushtohej rolit, kështu se kisha para vetes një njeri tej mase të përkushtuar e të dhënë pa asnjë rezervë pas kauzës shqiptare.

Isak Guta ishte i interesuar dhe shumë i angazhuar përingjalljen organizative të mërgimtarëve tanë, sepse ishte i ndërgjegjshëm për ndihmën e madhe që ata mund t'i jipnin vatrës në këtë moment të rendësishëm historik të kthesës së madhe. Veç luftës duhej fituar edhe paqja. Ai gjithmonë diasporën e ka shikuar si një Shqipëri tjetër, të jashtme që bën gjithçka për atdheun, një engjëll mbrojtës të saj. Pas tryezës dhe debatit që u zhvillua në takimin e sipërpërmendor shkuam në klubin „Oda shqiptare“ në kryeqytetin gjerman ku patëm mundësi të vazhdojmë diskutimin e të njihemi nga afër. Më kanë mbetur në kujtesë fjalët e tij: „Kam shumë pak jetë për të punuar për çështjen tonë kombëtare.

Mundohem që të punojë, të shkruajë, të hedhë sa më shumë në hambarin kombëtar.“ Për gjérat e mëdha me të vërtetë koha është e pamjaftueshme! Isak Guta ishte i vetëdijshëm se për çështjen tonë të madhe secili duhej të jekte më të mirën e tij, sepse vetëm kështu „hambari kombëtar“, siç e quante ai figurativisht çështjen tonë të përbashkët kombëtare, do të ishte plotë, dmth. kështu do të sigurohej ekzistenca e kombit tonë. Menjëherë e kuptova se kisha para vetes një njeri tej mase të përkushtuar e të dhënë pa asnjë rezervë pas kauzës shqiptare.

Në vitet në vazhdim ne u njohëm edhe më mirë me njëritjetrin. Në një varg aktivitetesh kulturore ku Isak Guta dha një kontribut të çmuar kuptova se kisha të bëja me një njeri që kurrë nuk iu kishte shumangur detyrimeve atdhetare dhe kishte punuar me të gjitha mundësitë që kishte përmobilizimin e shqiptarëve përmomentin vendimtar. Dhe atë moment ai e përfjetoi gjatë Luftës së Clirimtare në vitet 1998 e 1999. Isak Guta nuk e pranoi kurrë Jugosllavinë si shtet legal në hapësirën tonë etnike.

Vetë emri i shtetit i përashtonte shqiptarët nga përbërja e tij, sepse në fakt kjo ngrehinë shtetërore që në krye të herës ishte koncipuar si një shtet për sllavët e jugut dhe jo për shqiptarët. Në programin e këtij shteti, zhbërrja e shqiptarëve si entitet ishte pothuajse e vetëkuptueshme, një detyrim përlitën e këtij shteti. Viti 1913 i Konferencën e Londrës që e ndau Shqipërinë dhe gjysmën e territorave të saj ia dha dy mbretërive sllave që më vonë u bashkuan edhe me popujt e tjerë sllavë në një mbretëri të vëtme, përsaq Gutën ishte viti i tragjedisë së Luftës së madhe kombëtare.

Pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit më 1881, ndarja e Shqipërisë në vitin 1913 përbënte ngjarjen e dytë të madhe të defaktorizimit të shqiptarëve, të cilët po bëhen në gjithnjë e më të vegjël dhe më të parëndësishëm për Ballkanin. Dhe, çka është më e rendësishëmja, përveten e tyre! Isak Guta kishte studiuar për filmin në Pragë të Çekisë që atëherë quhej Çekoslovakia. Përgatitjen e tij profesionale ai vuri në shërbim të diasporës shqiptare që atëbotë luftonte me mjete politike përcilim nga Serbia. Në Düsseldorf ai i organizoi mërgimtarët tanë në fushën e kulturës, formoi grupin teatral.

Kështu ai synonte që diaspora jonë të dëshmonte se edhe në kulturë ajo nuk e pranonte diktatin serb. Jugosllavia, ky shtet kundërshqiptar, në atdhe anëtarët e organizatave ilegale i arrestonte dhe i dënonit, kurse në diasporë i vriste, por megjithatë nuk arrinte që t'i nënshtronë shqiptarët përderisa ata ishin në gjendje të zhvillonin edhe aktivitet kulturor jashtë kontrollit të saj. Shkurt, kultura në shtetë e tij ishte një fushë e gjerë e veprimit atdhetar që e mbante gjallë fryshtë e qëndresës. Vrasja e Jusuf e Bardhosh Gërvallës e Kadri Zekës për të kishte qenë një moment i kristalizimit të vetëdijes se përlirinë e kombit shqiptar njeriu duhej të ishte i gatshëm të vdiste në çdo moment.

Nëse kjo jetë kishte ndonjë

vlerë, atëherë vlerën asaj ia jepte pikërisht lufta me përkushtim absolut përcilimin e ardheut, pa përfillur asnjë rrezik. Tani çështja e madhe i kishte dhe heronjtë e saj që para së gjithash ishin dhe heronjtë e Isak Gutës. Në vitet e luftës së Clirimtare, ai u vu në mbështetje të Ushtrisë Clirimtare të Kosovës që prej momentit që ajo u paraqit në jetën tonë publike, dmth. që nga prilli i vitit 1996 dhe dha gjithçka që kishte mundësi përtë dhënë, në mënyrë që lufta e armatosur përliri të kurorëzohej me sukses.

Pas shumë dhjetëvjeçarësh aktiviteti intenziv në shërbim të atdheut, pas 12 qershorit të vitit 1999, Isak Guta këtë përvjohet përmes tij, në të cilat ai vazhdon të jetojë. Tani, thoshte ai tërthorazi, ishte koha e librit, lufta duhej të vazhdonte përmes tij, me mjete të tjera, sepse vetëm një popull i ndriçuar në shpirt e në mendje do të ishte i gatshëm të mbronte në çdo çast lirinë e tij të fituar me gjak. Isak Guta u largua nga vendlindja e tij shumë herët, si fëmijë, në kohën e zezonës, në vitet 1950, kur ishte vetëm 12 vjeç.

Ishte, pa asnjë dyshim, largim i dhunshëm, dëbim. Ishin kohë të vështira ato vite kur Beograd ishte tërbuar politikisht, prandaj e rriti trysninë e aparatit represiv të shtetit, në formën e veprimtarisë kriminale të UDB-së, mbi popullsinë shqiptare përtatë thyer përfundimisht shpirtin e saj qëndrestar. Spastrimi etnik, përliri të cilin është folur aq shumë në këto 30 vitet e fundit dhe vazhdon të flitet ende përliri, në Kosovë ka qenë realitet që në vitin 1913, edhe përsaq Gutës ai atëherë kishte një emër tjetër: quhej masakër.

Austriaku Leo Frojndl (Leo Freudenthal) na ka lënë dëshmi rrëqethëse përliri kohë. Një gazetar tjetër nga Rusia, Leon Trotzki, që shkruante në këtë kohë nga Ballkani, e ka dokumentuar masakrën e shqiptarëve në Kumanovë që përbën një prej masakrave më të mëdha të këtij viti të përgjakshëm. Shqiptarët përndiqeshin në forma të ndryshme, por ky trajtim jonjerëzor i tyre nuk i mjaftonte qarqeve shoviniste në Beograd, kështu që atje vazhdimisht bëhen në hartoheshin elaborate e memorandume përdëbimin masiv të shqiptarëve nga viset e tyre. Çdo shqiptar ishte në shenjëtë të kësaj politike kriminale që assosi nuk mund të pajtohej me faktin se në këtë dëshmon histori, serbët u treguan shumë të egër, të pamëshirshëm e mizor. Ne të tjerët, në një moment të dhënë, të favorshëm përliri, e kërkoni marrëveshjen, me shqiptarët



marrëveshjes jugosllavo-turke të vitit 1938 përdëbimin e shqiptarëve në Turqi. „Iseljevanje Arnauta“ e Vasa Ćubrilović-it e dëshmon faktin se elitat serbe pandërpërre janë marrë me hulumtimin e rrugeve dhe gjetjen e mënyrave efektive përdëbimin e shqiptarëve nga vatrat e tyre të lashta.

Në emër të historisë veprohej në mënyrë kundërhistorike. Historiografia serbe konstruktante gjithfarë skenarësh përliri të arsyetur politikën kundërshqiptare të Beogradit politik. Autoktonia e shqiptarëve kontestohej jo vetëm në politikë, por edhe në të ashtuquajturat shkenca serbe. Kontestimi i prejardhjes sonë ilire është ndërtuar mbi themellet e kësaj politike kundërshqiptare. Mund të thuhet se që prej projektit „Načertanija“ të Ilija Garašanin-it në mesin e shekullit XIX Serbia nuk pushoi së shëstuar plane përvetësimin e tyre të plotë dhe zbrazjen nga shqiptarët. Ajo donte hapësirë dhe jo njerëz që nuk do të pranonin kurrë projektet e saj politike shtetomëdha.

Në këtë kuptim ekspansionizmi serb ishte në armiqësi edhe me gjithë popujt e tjerë, jo vetëm me shqiptarët, por, me shqiptarët, siç e dëshmon historia, serbët u treguan shumë të egër, të pamëshirshëm e mizor. Ne të tjerët, në një moment të dhënë, të favorshëm përliri, e kërkoni marrëveshjen, me shqiptarët

ata, serbët, si dje ashtu edhe sot, ajo që ndodh sot në Veri nuk përbën asgjë të re, kurrë nuk deshën të merren vesh, nuk synuan marrëveshje, por thjesht zhdukjen e tyre fizike.

Shprehja se shqiptari është i mirë vetëm si shqiptar i vdekur nuk ka lindur rastësish në mesin serb. Jugosllavia komuniste pati premtuar barazi për shqiptarët dhe realizim të parimit të vetëvendosjes, por ajo shpejt i harroi premtimet e saj dhe e ndryshoi në mënyrë rrënësore kursin e saj politik, duke u kyqur në traditën e Jugosllavisë mbretërore.

Aleksandar Ranković-i kishte filluar në dimrin e vitit 1956 aksionin përmblledhjen e armëve që shqiptarët nuk i kishin se kur i kishin pasur, kishin ditur ç'të bënë me to. Kryengritja e Ferizajt në vjeshtën e vonë të vitit 1944 tregon se shqiptarët e kësaj anë kur ende kishin armë ishin të vendosur përliri të mbrojtur vreten e tyre. Më 2 dhjetor 1944 ata i priten partizanët në llogore lufte. Ripeshtimin serb aq shumë e urrenin saqë më parë vdisnin se nënshtroheshin. Por në vitin 1944 e 1945 në botë zotëronte një konjunkturë tjetër, përliri e shqiptarëve askund nuk mund të gjeje mirëkuptim e mbështetje, kështu që Kryengritja e Ferizajt u shpët relativisht lehtë nga çetnikët që ishin konvertuar në partizanë. Ende edhe sot përliri tjetër tjetër u detyrua të marrë rruget mërgimit.

Vdekja sjellë me vete pikëllimin dhe hidhërimin e thellë kur paraqet fundin, por kur ajo është diçka tjetër, dmth. kur nuk është fund, por fillim i diçkaje të re, me fjalë të tjera kur ajo është pjesë e një kthesë të madhe, atëherë më nuk mund të flasim përliri pikëllim, por shpresë.

Isak Guta u lind në verën e fundit të Shqipnisë, siç quhej atëherë në popull shteti titullar, dhe vdiç në një verë tjetër që ndoshta do të jetë vera e kthesës së madhe përfatet e Shqipnisë.

# Vdekja e arsyes: Pse të mos flasin edhe kinezët shqip?

Nga: Fatos TARIFA

Për të mënjanuar çdo keqkuptim, deklaroj që në hyrje dy të vërteta: E para, unë nuk jam as gjuhëtar, as historian. E dyta, unë e dua gjuhën time, shqipen, të cilën gjithnjë jam përpjekur e përpinqem ta flas e ta shkrat drejt, saktë dhe bukur dhe, po kështu, jam shumë i interesuar ta njoh objektivisht historinë e vendit dhe të popullit tim.

Këto dy të vërteta që sapo deklarova më shtyjnë të shkrat përmes një dukuri që, edhe pse jo masive, është bërë shqetësuese për shumë njerëz te ne. Jo vetëm në rrerhet akademike, por edhe në radhët e shumë qytetarëve që kanë një sens realist në gjykimet e tyre, ose një common sense, nëse më lejoni të përdor një term që, i huazuar prej Aristotelit, përdoret sot gjërisht në gjuhën e përditshme thuajse kudo.

Mbrëmë, një meme që qarkullon në rrjetet sociale, u bë shkak i një vargu shkëmbimesh online – disa serioze, disa humoristike – me miq e shokë. Çfarë thuhet në atë meme me dy fjalë, është kjo: Shqipëria është përsëri “kérthiza e botës”.

Nëse për Enver Hoxhën Shqipëria socialiste ishte vetëm një “fanar ndriçues” përmes një ardhmen e njerëzimit, përmes disa shqiptarë të sotëm vendi ynë është “origina e gjithçkaje” mbi Tokë dhe gjuha shqipe “e para gjuhë që ka folur njerëzimi”!

\*\*\*

Një milenium para erës së re, duke mos pasur as më të voglën ide mbi qytetërimet e tjerë në Perëndim, kinezët besonin se perandoria e tyre shtrihej në qendër të botës, e rrethuar nga popuj barbarë, ndaj edhe e quajtën atë “Perandoria e Qendrës” (Middle Kingdom). Një milenium para kinezëve ishin egjiptianët ata që e quajtën perandorinë e tyre “Perandoria e Qendrës”. Pas tyre ishin grekët e lashtë ata që e bënë Evropën “qendër të botës”, edhe pse nijnin një pjesë shumë të vogël të këtij kontinenti – kryesish bregdetin e verior dhe atë jugor të Mesdheut dhe disa territorë në veri dhe në lindje të tij. Kur u zbulua Amerika, ky kontinent u quajt “Bota e Re”, ndërsa evropianët vazhduan ta quanin kontinentin e tyre “bota e vjetër”. Të gjitha këto tashmë kanë rënë pasi disa shqiptarë, që shquhen përmes “patriotizëm” të flaktë dhe njohuri “të jashtëzakonshme” historike e gjuhësore (edhe pse, njëloj si unë, nuk janë as historianë, as gjuhëtarë), kanë “zbuluar” dhe besojnë – pa pasur nevojë të provojnë gjë prej gjëje – se asgjë në këtë botë që

popullohet nga tetë miliardë njerëz nuk bën kuptim dhe s'mund të shpjegohet pa ne, pa disa milionë shqiptarë dhe pa gjuhën shqipe.

Është krejt pa rëndësi të përmend emrat e atyre personave që janë autorë, mbrojtës apo përhapës të pikëpamjeve të tilla, ndaj edhe mjaftohem me ato çka ata besojnë dhe thonë. Dhe, çfarë ata thonë janë ide të tilla deluzive si:

“Në Romën e lashtë flitej shqip”; “gjermanishtja mund të kuptohet përmes shqipes”, në mos edhe ka rrjedhur prej saj: “në Francë është folur shqip”; “greqishtja është bijë e shqipes”; “shqipja është çelësi i të gjitha gjuhëve indo-evropiane”. Edhe Thoti, një prej perëndive në Egjiptin e lashtë dhe vetë egjiptianët kanë folur shqip. (Pse jo, a nuk flet shqip edhe nipi im Heru, që mban emrin e një prej perëndive kryesore të Egjiptit të lashtë).

Por, nuk janë vetëm këto. “Hebrejtë e zanafillës flisin shqip”; pellazgët po se po. Edhe “sumerët dhe aztekët e Meksikës flisin shqip”. “Krishti vetë ishte shqiptar”; “shqiptar ishte edhe Zeusi”. Shqipja është folur që në fillimet e njerëzimit; ajo është “gjuha e parë”, “mëma e të gjitha gjuhëve”. Gjuha shqipe është “gjuha e natyrës” dhe vetë “natyra ka folur shqip qysh nga fillimi”.


\*\*\*

Është një mori idesh nga më fantazmagoriket që disa, pa pikë droje, madje me shumë zell dhe me delirin e “zbuluesve të mëdhenj”, i thonë kudo që minden – në libra që i sponsorizonjë vetë, në artikuj gazetash, në intervista televizive, në portale dhe blogje të ndryshëm.

Edhe pse pikëpamjet e tyre variojnë, këta njerëz kanë të përbashkët tri gjëra: E para, ata vetë e shkratjnë dhe e flasin keq gjuhën shqipe. E dyta, pikëpamjet e tyre janë larg edhe prej asaj që mund të quhej “shkencë divulgative”.

E treta, këta njerëz janë me njëritjetrin në një garë që tashmë ka mbaruar, pasi dikush prej tyre e ka gjetur, më në fund, origjinën më të lashtë të gjuhës sonë – shqipja ka lindur bashkë me njeriun, si gjuhë e humanitetit, si gjuha e parë e Homo Sapiensëve, madje kjo gjuhë është e vjetër sa vetë natyra, sepse është “gjuha e natyrës”!

Që Zeusi ishte shqiptar dhe fliste shqip, kjo as duhet vënë në dyshim. C'mund të ishte tjetër Zoti i të gjithë zotave veçse një shqiptar dhe ç'gjuhë tjetër mund të fliste ai veç shqipes! Këtu mbyll çdo gjë dhe bëhet e panevojshme që t'i shkohet më thellë njohjes sonë! “Teoritë” e njerëzve të tillë,



sidoqoftë, kanë disa mungesa të ndjeshme, ndaj edhe kërkohet të zhvillohen më tej. Duhen më shumë hulumtime, më shumë se korrelacione iluzore, më shumë fantazi dhe, domosdo, më shumë zell “patriotik”.

Fjala vjen, ende nuk janë dhënë prej tyre prova të mjafueshme nëse ishin shqiptarët e Mesjetës së vonë ata që u vendosën mes banorëve indigenë të Meksikës në periudhën e tyre post-klasike (e njohur ndryshtë edhe si periudha e kulturës parakolumbiane) dhe u mësojmë përmes shkencës, por edhe fundi i vetë të menduarit racional: Vdekja e arsyes.

Unë nuk e di se çfarë i lidh me shkencën ata individë që historinë e shqiptarëve e rrëfejnë si të ishtë një përrallë dhe gjuhën tonë e shpallin gjuhën e perëndisë. Kushdo që i kundërshton mendimet e tyre nuk është patriot, nuk i do Shqipërinë, as shqiptarët dhe aq më pak gjuhën e tyre.

A kuptojnë vallë këta njerëz se ç'është shkenca dhe ç'do të thotë të bësh shkencë! Tre mendimtarë të mëdhenj racionalistë do u vini në ndihmë të kuptonin se sa miliona vite larg janë ata nga ajo sipërmarrje e madhe dhe e vështirë që quhet shkencë – Francis Bacon, Karl Popper dhe Bertrand Russell.

Për parin, shkenca nuk bëhet duke sajuar “të vërteta” nga vëvetja, siç tjerri merimanga rrjetën e saj, as duke mbledhur pa kriter, andej-këtej, çdo gjë që të del përparrë.

Për Popperin, teoritë shkencore mund të testohen vetëm nëse ato provojmë t'i hedhim poshtë, jo t'i verifikojmë. Shkenca përmes një proces; ajo nuk është kurrë një e vërtetë përfundimtare.

Për Russellin, ata që thonë se e vërtetë është ajo që ata vetë mendojnë se është e tillë, nuk dinë se ç'thonë. Duke e vënë theksin në rëndësinë që ka shkencë mendimi racional kritik, Russell thoshte se mendimi kritik nënkupton edhe vetë reflektimin kritik ndaj çdo gjë që merret si mendim kritik.

Ata që janë shkencëtarë të vërtetë janë njerëz modestë. Arsyja është e thjeshtë: shkencëtarët e vërtetë e dinë se përballë një realiteti që është pafundësish i gjërë, i komplikuar dhe kurrë i njohshëm përfundimt, dijet e tyre janë veç pjesërisht, relativist dhe përkohësisht të sakta – asnjëherë të vërteta absolute e përfundimtare. Për ta nuk ka Zeus,

Krisht, fillim apo fund që të shpjegojë atë çfarë ata duan të zbulojnë e të kuptojnë.

\*\*\*

A i vlen të merremi me këta pseudostudiues, pseudohistorianë e pseudogjühëtarë shqiptarë, që gjithnjë e më shpesh po shfaqen në ekranet e disa televizioneve dhe në disa gazeta? Ndoshja jo! Por, nëse kur të keqen e ndeshim të shfaqet dhe kur e shohim të ndodhë rrimë e bëjmë sehir – si spektatorë të një shfaqjeje komike që mundet edhe të na argëtojë – dhe vetëm presim, e keqja dhe e pavërteta, sidomos kur kamuflohen si qëndrime dhe si një detyrë patriotike, hedhin rrënje lehtë, sidomos në radhët e një brezi të ri që lexon gjithnjë e më pak.

Interneti e ka bërë sot shumë të lehtë që dije të rreme – nga teoritë konspirative deri te njohuri që, edhe pse mund të synojnë një qëllim të mirë, janë të paverifikuara e të pavërteta – të përhapen masivisht e të krijojnë një mjedis jo miqësor për zhvillimin e arsimit e të shkencës. Interneti ka bërë të mundur edhe që njerëz pa asnjë meritë dhe pa asnjë kredibilitet shkencor të hiqen e të shiten sot para një publiku jo mirë të informuar si studiues apo shkencëtarë të vërtetë. Kjo, në vetvete, përmban një rrezik real.

Edhe pse nuk ka ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë çka thashë më sipër, kujtoj se, disa kohë më parë, kur një koleg im profesor, anëtar i Akademisë së Shkencave, më tha me mburje se ai është më i injohur në botë se sa Eqrem Çabej, pasi në Research Gate ai është më i cituar sesa Çabej dhe ka një “research interest score” më të lartë sesa gjuhëtar yni më i shqar.

Çfarë megallomanie! Kur Eqrem Çabej u nda ngajeta, në vitin 1980, Interneti nuk ishte asëndrrat më të guximshme të njerëzimit dhe, pra, nuk kishte se si vepra e shqar e tij të bëhej botërisht e injohur kudo dhe përkëdo, siç ndodh rëndom sot me çdo tezë masteri dhe me “studimet” e dhjetëra pseudohistorianëve, pseudoantropologëve apo shqiptarologëve diletantë si ata përmë cilët shkrona më sipër.

Ndërsa dëgjoja koleguna tim akademik të mburrej përmes “meritat epërore” të tij ndaj Çabejt të madh, aty për aty më erdhën ndër mend fjalët e tij ndjerit Prof. Zija Xholi, mendorit tim në Universitetin e Tiranës, kur na fliste me shumë pasion përfilozofët e lashtë grekë. “Ne të gjithë dimë sot shumë më tepër sesa dinte Aristoteli në kohën e vet”, thoshte Prof. Xholi, “por askush nga ne nuk është më i mençur se ai”.



## Sukses i madh nga Istogu në Kupën Evropiane

**ISTOG, 1 TETOR** - Istogu është kualifikuar në raundin e tretë të Kupës Evropiane për hendballiste. Te ky sukses i madh skuadra istogase arri me fitoren 29:27 ndaj skuadrës portugeze, 1 Maio/Ada. Fitoren për

kualifikim, Istogu e arriti të dielën në Pejë, me kthesën e madhe të bërë në pjesën e dytë. Pas pjesës së parë portugezet ishin në epërsi 14:13. Por në pjesën e dytë skuadra e Faruk Shalës shfaqqi shumë më tepër.

Krijoi epërsi prej disa golash, ndërsa në fund fitoi me dy gola dallim, që ishte mjaftueshëm për kualifikim. Të shtunën, Istogu kishte pësuar 31:30. Albina Rugova udhëhoqi Istogun drejt suksesit të

madh duke i realizuar nëntë gola. Gjashtë i kishte Tainara Luna Goncalves, ndërsa nga pesë i shënuan Arlinda Dinarica e Fatiha Haimer. Kontributi nuk ka munguar edhe nga lojtaret e tjera.



## Drita fiton derbin e qytetit, Ballkanin kryeson Superligën

EPOKA  
ERE

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 1 TETOR** - Derbi i Anamoravës i ka takuar Dritës që e mposhti Gjilanin me rezultat 2-0, në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan dhe i takoi javës së 8-të në Albi Mall Superligën e Kosovës. Drita kaloi në epërsi në minutën e fundit të pjesës së rregull, kur realizoi Almir Ajzerajt për 1-0. Ndërkohë, fitoren e vulosi tetë minuta para fundit të ndeshjes Ardit Tahiri, i cili e shfrytëzoi asistimin e Albin Prapashticës për të vulosur rezultatin final 2-0. Tash Drita ka 15 pikë dhe renditet në vendin e tretë, me një pikë më pak se Llapit dhe katër pikë më pak se Ballkani, që kryeson renditjen. Në anën tjetër Gjilani mbetet në vendin e shtatë me 7

pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua të dielën, Feronikeli 74 e mori një pikë në Klinë pasi luajti baras me Dukagjinin (1-1). Skuadra vendase kaloi në epërsi në minutën e katërt shtesë të pjesës së parë, kur realizoi Iljasa Zulfiu. Pesë minuta pasi filloj pjesa e dytë mysafirët nga Drenasi e rivendosën baraspeshën në rezultat duke barazuar rezultatin në 1-1 me golin e Florent Avdylit. Kampioni në fuqi, Ballkani para tifozëve të vet të shtunën ka shënuar fitore në duel me kryesuesin e deritashëm, Llapin, me rezultat 2-1. Për Ballkanin realizues ishin Nazmi Gripshi dhe Almir Kryeziu. Për llapjanët shënoi talenti Elvir Gashjani, në minutën e 72-të. Tani Ballkani kryeson renditjen me 19 pikë, tri më shumë se Llapit dhe ka një



ndeshje më pak të zhvilluar. Në ndeshjen tjetër, Malisheva ka shënuar fitore në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren në përballje me Lirinë (1-0). Golin e fitores për mysafirët e shënoi Ilir Mustafa, në minutën e 68-të nga

penalltia, pas paraprakisht Etnik Brruti u pengua brenda zonës nga portieri i Lirisë, Arlis Shala. Ndesha e fundit e javës së 8-të zhvillohet sot (e hënë) në Lipjan ndërmjet Fushë Kosovës dhe Prishtinës.

SUPERLIGA - Java 8	
Drita - Gjilani	2-0
Dukagjini - Feronikeli 74	1-1
Ballkani - Llapit	2-1
Liria - Malisheva	0-1
<b>Të hënën takohen:</b>	
15:00 Fushë-Kosova - Prishtina	
Tabela	
	Pikë
1. Ballkani	19
2. Llapit	16
3. Drita	15
4. Malisheva	12
5. Prishtina	10
6. Dukagjini	8
7. Gjilani	7
8. Feronikeli '74	7
9. Liria	6
10. Fushë Kosova	1

## Kampionia vazhdon me fitore, Ylli shkatërrroi Istogun



**PRIZREN, 1 TETOR** - Kampionia e Kosovës, Peja shënoi fitoren e dytë në Prince Caffe Superligë, ku mundi Proton Cable Prizrenin me shifrat 85:115 (18:25, 25:30, 23:27, 19:33). Pejanët e nisën më mirë ndeshjen dhe qysh në çerekun e parë tri herë kishin epërsi deri në shtatë pikë, aq sa e fituan edhe këtë pjesë 18:25. Mysafirët vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, për të ngritur epërsinë në 12 pikë, 35:47, ndërsa shkuan në pushim me shifrat 43:55.

Në periudhën e tretë, prizrenasit afroan epërsinë në 51:57, por kampionët e Kosovës sërisht u

shkëputën, deri në 16 pikë epërsi, ku shifrat pas 30 minutash ishin 66:82. Në dhjetë minutat e fundit mysafirët vetëm sa e shtuan epërsinë dhe triumfuan 85:115. Te vendasit u dalluan Urim Zenelaj me 14 pikë, katër kërcime e pesë asistime dhe Isaiah Kelly me 23 pikë, gjashtë kërcime e tri asistime, ndërsa te mysafirët më të mirët ishin John Chandler me 27 pikë, katër kërcime e katër asistime, Lis Shoshi me 21 pikë e 12 kërcime dhe Beck Terwell me 24 pikë e gjashtë kërcime. Proton Cable Prizreni ka dy humbje, kurse Peja ka dy fitore. Ndërsa Golden Eagle Ylli regjistroi

fitoren e parë në këtë edicion të Prince Caffe Superligës. Therandasit fituan me 50 pikë dallim ndaj Istogut me rezultat 126:76 (34:21, 31:14, 34:13, 27:28). Ylli ka një fitore e një humbje, kurse istogasit dy humbje. Takimi në palestrën "13 Qershori" nuk kishte shumë histori, me vendasit që dominuan nga fillimi deri në fund fituan bindshëm 126:76. Te vendasit u dalluan Valon Bunjaku me 22 pikë, shtatë kërcime e tetë asistime, Jalen Nesbitt me 23 pikë, gjashtë kërcime, katër asistime dhe Jan Palokaj me 22 pikë, katër kërcime e pesë asistime.

## Ferizaj nuk ia del ndaj Maccabit

**FERIZAJ, 1 TETOR** - Ndonëse janë angazhuar maksimalisht, hendballistet e Ferizajt janë ndalur në raundin e dytë të Kupës Evropiane. Të dielën Ferizaj e luajti ndeshjen e dytë me skuadrën izraelit Maccabi

Arazim Ramat gan. Skuadra izraelite fitoi në "Bill Clinton" me rezultat 33:24. Dallimi i madh në rezultat u bë në minutat e fundit. Pjesa e parë përfundoi 16:13 për Maccabin. Lëndimi i portierës së Ferizajt, Kaba Teninke, në

minutat e parë, e ka pasur ndikimin e madh në rezultat. Teninke të shtunën shkëlqeu, por përfat të keq u lëndua herët të dielën. Amanda Stein u dallua te Ferizaj me nëntë gola. Shtatë i kishte Amanda Lemos, ndërsa tri i shënoi

Luljeta Esati. Ferizaj ka bërë hap të madh para në krahasim me paraqitjet e kaluara në gara evropiane. Tashmë ka një skuadër garuese që pritet të rivalizojë skuadrat tjetër në garë për titull dhe përkupë të Kosovës.



## Bonucci: Kisha ofertë nga Lazio, por vendosa të vij tek Union Berlin

**BERLIN, 29 SHTATOR** - Ish-mbrojtësi i Juventusit, Leonardo Bonucci, ka folur së fundmi për vendimin e tij për të kaluar tek Union Berlin, teksha zbuloi që kishte pasur ofertë edhe nga Lazio. Në një konferencë për shyp, italiani theksoi se ndihet i lumtur për

zgjedhjen që ka bërë. "Kisha dy opsione për të zgjedhur mes Lazios dhe Union Berlinit. Në fund të gushtit zgjodha Union Berlin. Pashë dy ndeshjet e para të Bundesligas dhe jam shumë i lumtur që erdha këtu për atmosferën, tifozët dhe ekipin.

Më pas fola me trajnerin dhe vendosa ta pranoj ofertën e Unionit për të përjetuar atë që ndoshta do të jetë sezoni im i fundit. Kam luajtur për 20 vjet në Itali dhe mendoj se ky vendim është shumë i rëndësishëm sepse në fund të

karrierës sime dua të jem një trajner. Besoj se ky vendim ma hap mendjen për gjëra të ndryshme si stili i jetesës dhe metodat e stërvitjes, gjëra që janë krejtësisht të ndryshme në Gjermani në krahësim me Italinë", ka deklaruar Bonucci.



## Hyseni për çmimin 'Ylli i javës': Motiv për të shënuar edhe gola të tjerë

"Epoka e re"

**PODUJEVË, 29 SHTATOR** - Futbollisti i KF Llapit, Muhamet Hyseni, e ka fituar çmimin "Ylli i javës" për javën e 7-të të Albi Mall Superligës. Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Muhamet Sylejmani, Selatin Jerliu, Fatmir Mehmeti, vendosi që epiteti i më të mirit përkëtë xhiro t'i takojë sulmuesit të skuadrës llapjane, pasi në ndeshjen në udhëtim kundër FC Malishevë ishte lojtari më i dobishëm dhe efikas në fushë duke shënuar, duke i mundësuar kësijoq ekipit të tij që në minutat shtesë të fitojë tri pikë të rëndësishme për ta ruajtur kreun e tabelës në elitë. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e KF Llapit, Muhamet Hysenit ia dha Andi Sadiku, dizajner grafik në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim, Hyseni



u shpreh i lumtur për vlerësimin duke premtuar spektakël golash edhe në xhirot e ardhshme, përfaktin që skuadra e tij po tregon karakter të lartë. "Jam jashtëzakonisht i lumtur që jam shpallur 'Ylli i javës'. Ky çmim më motivon edhe më shumë për të punuar dhe realizuar edhe gola të tjera që së bashku të arrijmë sukses", ka thënë Hyseni përfaqen zyrtare të FFK-së.

edicionin e ri dhe jemi në rrugën e duhur për t'i arritur objektivat tonë. Kam besimin maksimal të shtabit teknik, bashkëlojtarëve dhe tifozëve, gjë që u falënderohem në maksimum. Tifozëve u premtoj edhe gola të tjera që së bashku të arrijmë sukses", ka thënë Hyseni përfaqen zyrtare të FFK-së.

## Fury: Njerëzit do të tallen me mua nëse humbi ndaj Ngannou, ashtu sikurse kur Unitedi humbi nga Liverpooli 7-0

**MANCHESTER, 29 SHTATOR** - Boksieri britanik Tyson Fury po përgatitet për duelin e 28 tetorit ndaj ish-kampionit të botës në UFC, Francis Ngannou. Kjo sfidë do të zhvillohet në Arabi. Fury, kampion bote në peshën e rendë, në një intervistë me Rio Ferdinand, u shpreh se humbja ndaj Ngannou do të ishte po aq turpëruese sa humbja 7-0 e Manchester Unitedit me Liverpoolin sezonin e kaluar. Kur u pyet se çfarë kërcënimi paraqet Ngannou, Fury u përgjigj: "Ai është i fortë fizikisht, një grushtues dinamit me të dyja duart. Ai është regjistruar në librin e rekordave Guinness si grushtues më i vështirë. Ka goditur ndonjëherë ndonjë gjë, kështu që ekziston ai rrezik. Rreziku më i madh nga të gjithë është të luftosh me një luftëtar MMA dhe unë jam kampioni i botës në peshën e rendë, kështu që çfarë ndodh nëse



ai me mund mua? Njerëzit do të tallen me mua. Do të ishte njësoj si atëherë kur Manchester Unitedi u mund 7-0 nga Liverpooli. Apo jo?", u shpreh Fury, i pamposhtur në karrièren e tij. "Djatjtë e kuq" u poshtëruan nga rivalët e tyre kur luajtën më 5 mars në "Anfield". Kjo ishte humbja më e madhe e Manchester Unitedit në Premierë Ligë dhe humbja më e keqe që kur Erik ten Hag u bë trajner më 2022. Fury është tifoz i Manchester

Unitedit. Ajo humbje mund të jetë e dhimbshme për të si tifoz, humbja ndaj Ngannou do ta dëmtonte shumë moralisht kampionin e pamposhtur të botës në peshën e rendë. "Të gjithë këta kundërshtare me të cilët përbalem, të gjitha janë luftime të rrezikshme ose janë të gjithë burra të mëdhenj. Të gjithë këta djem janë gunga të mëdha dhe kur i luftoj rreziku është gjithmonë i njëjtë. Ata kanë një shans përgoditje me grusht. Por nuk lë kurrë gur pa lëvizur", ka deklaruar Fury. "Unë gjithmonë bëj gjithçka që mundem për të qenë i suksesshëm. Mënyra se si e shikoj është, nëse ky djalë do të më mundë, atëherë do t'i shtrëngoj dorën. Ai duhet të jetë një luftëtar i mirë, sepse unë nuk jam njeri i lehtë për t'u mposhtur siç e kam treguar gjatë viteve", ka shtuar Fury.

## Reali nuk synon vetëm Mbappen, por edhe Sonin

Real Madridi nuk po planifikon vetëm transferimin e Kylian Mbappes nga PSG-ja, por edhe kapitenit të ri të Tottenham Hotspurit, Son Heung-Min. 31-

vjeçari korean është pjesë e Tottenhamit prej vitit 2015, derisa ka kontratë deri në vitin 2025, kurse ka shënuar 5 gola deri tani në Premierligë, duke e

ndihmuar skuadrën të bëjë mirë dhe të sigurojë rezultate pozitive. Vetë Son shpreson të luajë një ditë me skuadrën më titulluar në Evropë. Shumë

vite në ishull me Tottenhamin dhe vetëm dy finale të humbura (Champions+Carabao). Son dëshiron të fitojë trofe dhe Reali është mundësia më e

mirë për ta bërë. Gjithsesi, arritja e akordit me presidentin Daniel Levy nuk do të jetë një mision i lehtë përsanjollët.

## SHKURT

Arsenali pa kat°r titullar ndaj Bourne... Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, nuk do të ketë një dispozicion të paktën katër futbollistë titullarë në ndeshjen që skuadra e tij do ta zhvillojë të shtunën ndaj Bournemouthit. Është vetë trajneri ai që konfirmoi mungesat. Fjala është për Declan Rice, Gabriel Martinelli, Leandro Trossard dhe Bukayo Saka, të cilët nuk janë stërvitur që nga derbi i Londrës veriore në fundjavën e kaluar kundër Tottenhamit (2-2). Kësaj liste i shtohen edhe Thomas Partey, Jurrien Timber dhe Fabio Vieira. Kjo do të thotë se trajneri duhet të ndërtojë sérish një ekip të ri, siç bëri të mëkurën, kur fitoi 1-0 ndaj Brentfordit në Kupë.

Eto o akuzohet p°r kurdisje t° rezultate

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kamerunit që nga dhjetori 2021, Samuel Eto'o, është subjekt i një hetimi. Ish-sulmuesi i Interit dhe Barcelonës, pas akuzave të ish-zëvendëspresidentit federal, po hetohet nga policia me akuzën se ka kurdisur ndeshjet e kategorisë së dytë për të ngjitur Victoria Unitedin në kategorinë e parë. Kështu shkruan "The Guardian". Sipas saj, personi në fjalë ka hedhur poshtë të gjitha akuzat. Gazeta e njohur britanike raporton se hetimi do të jetë më i gjerë dhe do ta prekë të gjithë federatën, që nga momenti kur në krye të saj u vendos ish-sulmuesi i Barcelonës. Ky hetim mund të përfshijë deri në 40 persona.

Mourinho: „sht° fillimi m° i keq n° kati time

Trajneri Jose Mourinho është munduar të arsyetohet pasi Roma pësoi humbje të thellë nga Genoa me rezultat 1-4. Trajneri portugez ka theksuar se është fillimi më i keq në karrièren e tij por që, sipas tij, Roma luajti dy finale evropiane radhazi falë tij. "Është fillimi më i keq në karrièren time. Megjithatë, mendoj se është hera e parë që Roma luan dy finale evropiane radhazi", u shpreh Mourinho. "Është skuadra që kemi dhe me këtë skuadër duhet të dalim nga kjo situatë. Nuk ka më afat transferimi. Askush nuk mund të largohet apo të arrijë. Ky është grupi që kemi me cilësitetë dhe problemet e tij. Nuk kemi kohë për të qarë. Mund të qajmë nga brenda, sepse na dhemb zemra, veçanërisht përmë për shkak të raportit tim me tifozët e Romës. Por do t'i kthehem i punës. Ndesha tjetër vlen tri pikë, jo shtatë apo tetë, por bëhet një ndeshje shumë, shumë e rëndësishme për ne", ka deklaruar Mourinho.

Ten Hagen e ka besimin e Unitedit

Drejtuesit e Manchester Unitedit janë të kënaqur me punën e Erik ten Hag, edhe pse ky sezon nuk ka nisur shumë mirë. "Djajtë e Kuq" renditen pas javës së gjithështë në vendin e nëntë në Premierligë me 9 pikë të grumbulluara. Tri fitore dhe po qaq humbje për Unitedin, që dështoi edhe në sfidën e parë të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve kundër Bayern Münchenit. Gjithsesi, optimizmi në kampin e kuq është i madh dhe besimi kundrejt teknikut holandez është i palëkundur. Drejtuesit po përgatitin rinovimin me Ten Hag, të cilin duan të mbajnë gjatë në "Old Trafford". 53-vjeçari ka kontratë deri më 2025, por tek Unitedi duan ta zgjatin më shumë bashkëpunimin me të. Një vendim që konfirmon pozitat e palëkundura të trajnerit, por edhe një mesazh i qartë për lojtarët që nuk kanë marrëdhënien të mirë me të si Sancho.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



[facebook](#)


[www.facebook.com/gjeipuneshpeite](http://www.facebook.com/gjeipuneshpeite)

## RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumé's Details

[lumesdetails](#)

Abraja Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leart Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Bajram Curri", Krushe e Madhe.
- Edi Xhezairi shpall të pavlefshme diplomën, dëftesat, certifikatën shne "Ymer Prizreni" Prizren.
- Kemajl Beka shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".
- Sara Ibishi shpall te pavlefshme dëftesat diplomën e shkollës së mesme të lartë "Xheladin Deda".
- Muhamet Kurta shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani" ish shkolla "Boris Kidric".
- Lëshoj lokal më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesë me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesë e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesë një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesë e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

